



EUROPEAN UNION'S CROSS BORDER COOPERATION PROGRAMME

# ANALIZA DHE STRATEGJIA PËR MARKETING, PROMOVIM DHE BRANDIM TË NJË PAKETE UNIKE TURISTIKE KRUSHEVË/ELBASAN



This project is funded  
by the European Union



**ALKA**  
Center for Sustainable Development



Ky dokument është përgatitur me ndihmën e Bashkimit Evropian, në kuadër të projektit “Krusheva dhe Elbasan – destinacione turistike të njohura ndërkufitare”, Marrëveshja e Grantit nr. 2021/429-426.

Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi e vetme e institucioneve dhe organizatave që e zbatojnë projektin dhe në asnjë rast nuk mund të konsiderohet se i pasqyron pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

Publikuar nga

Qendra për Zhvillim të Qëndrueshëm ALKA

Koordinimi nga

Tome Hristovski – Komuna Krushevë

Gledian Llatja – Bashkia Elbasan

Elizabeta Gjorgjievska - Qendra për Zhvillim të Qëndrueshëm ALKA, Shkup

Arian Çala – Organizata Tjetër Vizion, Elbasan

Përgatitur nga

Dr.Elvira Fetahu

MBA Emilia Geroska

Përkthyer dhe lektoruar nga

APMM - Shkup

Dizajn nga

Kontura SHPK - Shkup

# LISTA E SHKURTESAVE

KET	KET	Krushevë Elbasan Turizëm
ATTA	ATTA	Shoqata për udhëtime aventuristike
ATV	ATV	Automjete për të gjitha terrenet
CB	CB	Ndërkufitare
CBC	CBC	Bashkëpunimi ndërkufitar
B&B	B&B	Fjetje me mëngjes
B2B	B2B	Biznes me biznes
B2C	B2C	Biznes me klient
COVID 19	COVID 19	SARS-CoV-2
DMO	DMO	Organizata e Menaxhimit të Destinacionit
DMP	DMP	Plani i Menaxhimit të Destinacionit
EU	BE	Bashkimi Europian
FAM Tour	Turne FAM	Turne për familjarizim (njohje)
FB	FB	Facebook
F&F	F&F	Fakte dhe numra
GDP	PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto
IG	IG	Instagram
IPA	IPA	Instrumenti për Asistencë Para-Aderimit
LED	LED	Zhvillimi Ekonomik Lokal
LRCP	PKLR	Projekti i Konkurrueshmërisë Lokale dhe Rajonale
LSG	NJVL	Njësia e Vetëqeverisjes Lokale
OJQ	OJQ	Organizata Joqeveritare
ROI	ROI	Kthimi i Investimeve
SEO	SEO	Optimizimi i motorit të kërkimit
TCCI	TCCI	Indeksi i kapacitetit mbajtës turistik
ToR	ToR	Termet e referencës
UNWTO	UNWTO	Organizata Botërore e Turizmit e Kombeve të Bashkuara
USP	USP	Propozim unik për shitje
UVP	UVP	Propozim unik për vlerën
WS	WS	Punëtoritë
WTO	OBT	Organizata Botërore e Turizmit
WTTC	WTTC	Këshilli Botëror për udhëtime dhe turizëm
VFR	VFR	Vizita të miqve dhe të afërmit

# HYRJE

Ky dokument është zhvilluar në kuadër të Projektit “Krusheva dhe Elbasani – destinacion i njohur turistik ndërkufitar”, i mbështetur nga Programi IPA II për bashkëpunim ndërkufitar Maqedonia e Veriut-Shqipëria. Projekti synon rritje afatgjatë stabil dhe të qëndrueshëm të turizmit që do të krijojë ekuilibër midis aspekteve mjedisore, ekonomike dhe socio-kulturore të turizmit për të garantuar përfitime afatgjata për komunitetet dhe vendet si zona ndërkufitare (niveli i ndikimit).

**“Analiza dhe drejtimet strategjike për promovimin e paketës turistike Krushevë - Elbasan”** është në përputhje me përpjekjet në nivel projekti për të vendosur një drejtim të përbashkët strategjik për zhvillimin e mëtejshëm të destinacionit Krushevë - Elbasan si një destinacion hiqe i unik tematik turistik me fokus në produkte turistike aktive dhe aventuristike. Në këtë drejtim, gjetjet dhe rekomandimet e analizës rezultojnë nga konsultimet e gjera me literaturën ekzistuese mbi temën dhe grupin e synuar primar: ofruesit e shërbimeve turistike në Krushevë dhe Elbasan. Për këtë qëllim, në kuadër të projektit u zhvillua një proces intensiv konsultativ me pjesëmarrje dhe përfshirje të lartë të vetëqeverisjes lokale, sektorit privat dhe civil.

Objektivi i dytë specifik i projektit KET përfshin: Zhvillimin e promovimit të integruar turistik dhe përgatitjen e shërbimeve konkurruese turistike dhe hotelierike brenda zonës ndërkufitare Krushevë - Elbasan për të tërhequr turistë dhe vizitorë vendas dhe të huaj.

Për të arritur qëllimin e mësipërm u angazhuan dy eksperte me përvojë të turizmit, prof. Asoc. Dr. Elvira Fetahu dhe MBA Emilia Geroska, për të hetuar mundësitë ekzistuese (analiza e situatës) dhe mundësitë potenciale (analiza e literaturës dhe kërkimi në terren) për zhvillimin e mëtejshëm të turizmit aktiv dhe aventuristik në Elbasan dhe Krushevë, përkatësisht. Detyrat e mësipërme u realizuan nga maji deri në shtator 2022, me mbështetje logjistike nga të gjithë aktorët relevantë për zhvillimin e turizmit në dy Bashkitë, Krushevë dhe Elbasan.

Dokumenti përbëhet nga dy pjesë kryesore. E para i referohet analizës së situatës ekzistuese sipas metodologjisë që elaboruan më poshtë. Në pjesën e dytë janë paraqitur gjetjet dhe rekomandimet që përcillen me drejtimet strategjike bazë për marketingun e mëtejshëm, promovimin dhe brendimin e destinacionit Krushevë – Elbasan si një paketë turistike unike aktive dhe aventuristike.



## I. METODOLOGJIA

Qëllimi kryesor i këtij dokumenti është të elaborojë mundësitë për zhvillimin e destinacionit, të zhvillojë një kuptim të fortë, si dhe të marrë njohuri të vlefshme për situatën aktuale me zhvillimin e turizmit në Krushevë dhe Elbasan. Për hartimin e këtij dokumenti janë përdorur metoda të kombinuara kërkimore, duke përdorur të dhëna parësore dhe dytësore. Të dhënat paraprake u mbledhën duke përdorur dy metoda: punëtori dhe intervista të thelluara.

U organizuan dy punëtori të përbashkëta ndërkuftare me aktorët kryesorë të turizmit në Shqipëri (18-19.05.2022) dhe Maqedoninë e Veriut (08-09.06.2022) për të mbledhur përvoja, mundësi, pikëpamje dhe ide lokale nga palët e interesuara dhe përdoruesit relevantë nga Krusheva dhe Elbasani. Objektivi kryesor i këtyre punëtorive ishte gjenerimi dhe diskutimi i ideve për turizmin në të dy rajonet dhe zhvillimi i një produkti të përbashkët turistik. Në punëtori morën pjesë 48 pjesëmarrës (32 burra dhe 16 gra), të gjithë përfaqësues nga bizneset e hotelierisë, operatorë turistikë, administrata e pushtetit lokal, sektori civil, institucionet kulturore dhe komuniteti akademik. Këto aktivitete ishin një rast i shkëlqyeshëm për të diskutuar ballë për ballë për shqetësimet e aktorëve të turizmit në Elbasan dhe Krushevë. Në të njëjtën kohë, punëtoritë shërbyen si platformë e përbashkët ndërkuftare për analizën e gjendjes aktuale të turizmit në Krushevë dhe Elbasan përmes "rrahjes ideve" ("brainstorming") gjeresisht gjenerimit të ideve për zhvillim të mëtejshëm si një destinacion energjik duke ofruar një paketë turistike të përbashkët dhe konsistente. Analiza u fokusua në këto: identifikimi i potencialeve turistike në rajone, dizajnimi i ofertave dinamike turistike, diversifikimi i ofertave turistike, mënyrat më të mira për të promovuar dhe komunikuar Elbasanin dhe Krushevën si destinacion unik turistik, zhvillimin e programeve specifike akademike dhe profesionale arsimore për shërbime turistike, si dhe programe trajnimi për individë apo punonjës, të cilët janë të lidhur me sektorin e turizmit dhe të hotelierisë.

U zhvillua një ushtrim i përbashkët për dizajnimin të një paketë turistike nga perspektiva e ofertës në tregun turistik, pra nga këndvështrimi i ofruesve turistikë të destinacionit. Produktet e propozuara turistike u ekzaminuan në anën e kërkesës së tregut të turizmit - aspektet kryesore të një destinacioni aventure, duke përfshirë aktivitetet, atraksionet dhe aksesin. Pjesëmarrësit i kuptuan kërkesat e fushatës së marketingut dhe promovimit për promovim të mëtejshëm të destinacionit ndërkuftar aventuristik dhe aktiv.

Pas përfundimit të punëtorive, u realizuan intervista të strukturuar me pjesëmarrësit nga ekspertët. Intervistat ishin të dobishme për të kuptuar plotësisht opinionet, përvojat dhe propozimet e aktorëve kryesorë të sektorit të turizmit në Krushevë dhe Elbasan. Gjatë këtyre intervistave u trajtua lista e mëposhtme e temave dhe pyetjeve:

- Si mund të shihen Krusheva dhe Elbasani si atraksione turistike? Cili është identiteti i tyre?
- Çilat ngjarje dhe aktivitete janë bërë për turizmin në Krushevë dhe Elbasan dhe çfarë mund të bëhet më shumë?
- Si mund të përmirësohet marketingu për turizmin në Krushevë dhe Elbasan si destinacion i përbashkët turistik? Si mund të promovohet?
- Si mund të përmirësohet infrastruktura turistike?
- Çfarë mund të bëhet për të përmirësuar shërbimet turistike në përgjithësi?

Për të dhënat dytësore, u realizua një kërkim i gjerë përmes analizës dhe rishikimit të dokumenteve, planeve dhe strategjive që ishin në dispozicion për të dy vendet. Kërkimi u përdor kryesisht për një pasqyrë të përgjithshme të destinacioneve lokale të Krushevës dhe Elbasanit dhe potencialit të tyre turistik. Të dhënat zyrtare të marra për turizmin dhe çështje të tjera me interes u krahasuan me të dhënat zyrtare nga institucionet statistikore dhe bashkitë. Një vërejtje e përgjithshme, siç pritej, është se të gjitha dokumentet e shënuara dhe të konsultuara zbuluan drejtime të izoluara, strategjike të zhvillimit për destinacionet lokale Krushevë dhe Elbasan në vetvete, por që siguruan një bazë solide informacionesh për zhvillimin e mëtejshëm të përbashkët të paketave turistike me ofertën e destinacionit të përbashkët.

Mjetet e përdorura në kërkimin për këtë dokument ishin shumë të vlefshme gjatë elaborimit të mundësive për zhvillimin e një destinacioni të përbashkët tematik turistik ndërkuftar Krushevë-Elbasan.

## II. KONTEKSTI

Organizata Botërore e Turizmit (WTO) e përcakton destinacionin turistik lokal si një hapësirë fizike në të cilën një turist kalon të paktën një natë. Ai përfshin produkte turistike të tilla si shërbimet mbështetëse dhe atraksione dhe burime turistike brenda udhëtimit njëditor. Destinacioni ka kufij fizikë dhe administrativë që e përcaktojnë menaxhimin e tij dhe imazhet dhe perceptimet që e përcaktojnë aftësinë e tij konkurruese në treg. Destinacionet lokale përfshijnë aktorë të ndryshëm të interesuar, duke përfshirë edhe komunitetin –mikpritës. Destinacionet lokale mund të krijojnë rrjete për të formuar destinacione më të mëdha turistike (UNWTO 2007). Rasqyra fillestare e pesë elementeve të një destinacioni: Aksesit, Akomodimit, Atraksionet, Aktivitetet dhe Komoditetet përbëjnë një grup të qëndrueshëm në territorin e Krushevës dhe Elbasanit, me çka mundësohet elaborim i mëtejshëm për krijimin e një destinacioni unik tematik ndërkufitar Krushevë-Elbasan nga të dy vendet, Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria.

Në literaturën e UNWTO-së, deri më sot, nuk ekziston asnjë përkufizim për turizmin aventuristik. Në këtë dokument ne e ndjekim Asociacionin e Udhëtimeve Aventuristike (ATTA), e cila e përkufizon turizmin aventuristik si udhëtim i cili përfshin të paktën dy nga tre elementët e mëposhtëm: aktivitetin fizik, mjedisin natyror dhe zhytje kulturore. Pas shqyrtimit të produktit turistik të paraqitur më poshtë nëseksioni III: Analiza e situatës, tema më e fuqishme që i mbështet destinacionet lokale si një destinacion unik tematik është **aventura dhe udhëtimi aktiv**.

Në këtë aspekt, Krusheva dhe Elbasani janë **dy qendra turistike të një destinacioni tematik**.

### II.1 SEKTORI I TURIZMIT DHE POTENCIALI PËR ZHVILLIM EKONOMIK

Turizmi luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të një vendi. Shumë qeveri e shohin turizmin si një mjet të përshtatshëm për përmirësimin e bilancit të pagesave, tërheqjen e investimeve të huaja dhe zbutjen e papunësisë. Krahas efekteve të drejtpërdrejta të turizmit, si rritja e të ardhurave dhe rritja e vendeve të punës, ekziston edhe "efekti shumëfishues i turizmit". Kjo do të thotë se për të matur ndikimin e përgjithshëm të turizmit në ekonominë e një vendi duhet të marrë parasysh jo vetëm përfituesit e drejtpërdrejtë të të ardhurave nga turizmi, por edhe përfituesit indirekt. Këta mund të jenë prodhuesit e produkteve bujqësore, industria për prodhimin e ushqimeve dhe pije, prodhues dhe shpërndarës të aparateve apo pajisjeve industriale, dyqane me pakicë, banka dhe shumë organizata apo individë të tjerë, të cilët përfitojnë nga zhvillimi i turizmit.

Organizata Botërore Turistike e Kombeve të Bashkuara (UNWTO) ka parashikuar që ardhjet ndërkombëtare ose udhëtarët që shkojnë jashtë vendeve të tyre në mbarë botën, deri në vitin 2030 do të arrijnë deri në 1.8 miliardë, duke siguruar kështu turizmin si një nga aktivitetet ekonomike me rritjen më të shpejtë që e nxit zhvillimin e përgjithshëm, duke futur investime të reja dhe duke gjeneruar të ardhura dhe punësim të reja.

Për sa i përket shifrave, hulumtimi më i fundit vjetor i Këshillit Botëror për udhëtime dhe turizëm (WTTC) tregon:

Pas një humbje prej gati 4,9 trilionë dollarë amerikanë në vitin 2020 (-50.4% rënie), kontributi i udhëtimeve dhe turizmit në GDP (PBB) u rrit me 1 trilion USD (+21,7% rritje) në vitin 2021. Në vitin 2019, sektori i udhëtimeve dhe turizmit kontribuoi me 10,3% në GDP (PBB) globale, që u ul në 5.3% në vitin 2020 për shkak të kufizimeve të atëhershme të lëvizshmërisë. Në vitin 2021 përqindja u rrit në 6,1%.

Në vitin 2020, u humbën 62 milionë vende pune, që është një rënie prej 18,6%, duke lënë vetëm 271 milionë të punësuar në të gjithë sektorin në nivel global, krahasuar me 333 milionë në vitin 2019; në vitin 2021 u rikuperuan 18,2 milionë vende pune, që përfaqëson një rritje prej 6,7% në nivel vjetor. Pas rënies prej 47,4% në vitin 2020, shpenzimet e vizitorëve vendas u rritën me 31,4% në vitin 2021, ndërsa pas rënies prej 69,7% në 2020, shpenzimet e vizitorëve ndërkombëtarë në vitin 2021u rritën vetëm me 3,8%.

Shifrat e mësipërme mbresëlënëse i pasqyrojnë pasojat nga pandemia COVID-19 mbi udhëtimet, duke e vënë në pah rënien ekstreme të vizitave të turistëve të huaj në destinacionet dhe njëkohësisht e tregojnë rritjen e udhëtarëve vendas të cilët i eksplorojnë zonat rurale dhe qendrat "e blerta" turistike.

Përpara kufizimeve të udhëtimit për shkak të COVID-19, dëshmi të tërthorta nga Krusheva ([LRCP Vëllimi II – Planet për zhvillim të destinacioneve – Plani Nr.3: Plani për zhvillim të turizmit: Pellagonia](#)) kanë sugjeruar

se rritja e popullaritetit të Krushevës dhe Prilepit si destinacion për paragjajding i ka rritur dukshëm vizitat në zonën e Pellagonisë. Sipas vlerësimeve të ofruesve vendas në vitin 2017, jashtë kampionateve të paragjajdingut, Krushevo ka mirëpritur të paktën 1000 mysafirë ndërkombëtarë të cilët e kanë vizituar destinacionin për pushime të kombinuara me aktivitete të paragjajdingut ose për përgatitje për garat e ardhshme. Numri më i madh i vizituesve ishin nga Sllovenia, Anglia, Bullgaria, Serbia dhe vende të tjera të rajonit. Minimumi i qëndrimit për këtë segment është pesë ditë, qëndrimi më i zakonshëm është shtatë ditë, ndërsa në periudhën kur mbahen gara dhe kampionate, pjesëmarrësit qëndrojnë mesatarisht nga 14 ditë. Mesatarja e shpenzimeve të garuesve në paragjajding gjatë pushimeve, si dhe për paketat stërvitore është rreth 70 euro në ditë. Paketa për ata që merren me paragjajding në mënyrë rekreative, të cilët vijnë për t'u stërvitur me klubet lokale është 50 Euro në ditë ku përfshihen akomodimi me mëngjes, trajnerë dhe mbështetje lokale (transport lokal). Në shumën e mësipërme nuk janë përfshirë shpenzime për ushqim dhe pije apo shërbime të tjera që turistët mund t'i konsumojnë.

Në kohën e hartimit të analizës, tregu aktual i Krushevës, destinacioni nuk mund të vlerësohet për shkak të tendencave apo parashikimeve, duke vendosur tregues për rritjen e mbërritjeve apo kërkesës për destinacion vetëm sepse çrregullimi i më i madh i vlerësimit të udhëtimeve është pasiguria. Përveç COVID-19, luftës në Ukrainë dhe krizës globale energjetike, ka shumë gjasa, që edhe në vitin 2023 do të vazhdojë trendi i ardhjeve vendase.

Bazuar në intervistat me ofruesit e shërbimeve për akomodim në Krushevë (2022, Projekti KET), që mbështetet edhe nga statistikatat zyrtare, pjesa më e madhe (deri në 90%) e totalit të ardhjeve në vitin 2021 janë prej turizmit vendas duke përfshirë të gjitha segmentet e tregut brenda ekonomisë kombëtare: familjet, çiftet, miqtë, grupet private, grupet e vogla të organizuara, udhëtime ose vizita njëditore, fundjavë të zgjatur, pushime, pjesëmarrje në ngjarje. Shumica e vizitave kanë përfshirë të paktën një aktivitet fizik si ecje në natyrë, bjeshkatari, çiklizëm dhe kalërim.

**Tabela 1: Numri i vizitorëve, në Krushevë sipas viteve (2018-2021)**

Viti	Numri i vizitorëve vendas	Numri i vizitorëve të huaj	Gjithsej
2018	15038	2465	17503
2019	19876	2366	22242
2020	17561	343	17904
2021	18341	1318	19659

Burimi: Baza e të dhënave MakStat, gusht 2022

Në thelb, turizmi ka të bëjë me numrat – numri i vizitorëve, makinat, fluturimet, hotelet, apartamentet dhe kampet, restaurantet, klubet dhe kafenetë dhe si ato shifra ndikojnë në rritjen e destinacionit. Në rastin e Krushevës, vëllimi i turizmit mund të matet me numrin e fjetjeve pasi këta tregues lidhen drejtpërdrejt me rritjen e vendeve të punës, gjenerimin e të ardhurave dhe përmirësimin e përgjithshëm të ekonomisë lokale.

Tabela tregon se ndikimi ekonomik nga turizmi mbi ekonominë e i Krushevës ka potencial të madh. Gjeresisht në Krushevë, si destinacion, në dispozicion janë 1250 shtretër (shihni III.3 AKOMODIMI), ku zënia totale e akomodimit në vitin 2021 është 52.45 fjetje, gjë që tregon Krusheva gjatë gjithë vitit 2021 është vizituar me kapacitet të plotë vetëm për 42 ditë.

Llogaritja e mësipërme (në formën e saj më të thjeshtë, pa e marrë parasysh gjendjen sezonale) nënkupton që Krusheva ka mundësi të rrisë numrin total të fjetjeve në vit. Përfshirja në projekte ndërkufitare (CB) që ofrojnë paketa unike turistike aktive mund të jetë një nga mënyrat për të diversifikuar/ngritur ofertën aktuale dhe për të plotësuar në një numër të madh kapacitetin e akomodimit që është në dispozicion.



**Tabela 2: numri i fjetjeve në vit, Krushevë**

Viti	2017	2018	2019	2020	2021
Numri i fjetjeve	46741	51526	56660	44273	52454
Rritje e numrit të fjetjeve krahasuar me një vit më parë		4785	5134	-12387	8181
% e Rritje e numrit të fjetjeve krahasuar me një vit më parë		10.24	9.96	-123,87	81.81

Burimi: Baza e të dhënave MakStat, gusht 2022

Sa për krahasim, destinacionet brenda zonës ndërkufitare CB nga ana e Maqedonisë, të cilët ofrojnë përvoja të ngjashme (fshatrat rreth liqenit të Prespës dhe liqenit të Ohrit, qytetet në rrëzë të parqeve kombëtare dhe fshatrat malore) gjithashtu numëruan rritje të madhe të vizitorëve vendas në vitin 2021 për shkak të kufizimeve për udhëtime jashtë vendit. Kështu, edhe parashikimi i trendit nuk mund të bazohet në ndikime të jashtme të jashtëzakonshme të pasigurta. Megjithatë tendencat e fundit mund të përdoren në zhvillimin e drejtimit strategjik për zhvillimin e destinacionit me qëllim të promovimit të madh dhe rizbulimit të destinacionit lokal të Krushevës nga vizitorët vendas. Veç kësaj, sipas [Strategjia për Zhvillimin e Turizmit të Komunës së Krushevës 2020-2025](#), gjenerata e Mijëvjeçarit të ri dhe Genjerata Z do të bëhen forcat kryesore në lëvizshmëri, kurse udhëtimi i tyre mund të rezultojë në ndryshime të rëndësishme në tregun turistik (që ndërliohen me teknologjitë e reja dhe udhëtimet aventuristike).

Për shkak të pozicionit të tij gjeografik, Elbasani duhet të mbështetet në lloje specifike të turizmit, kryesisht aventuristike, historike dhe shëndetësore (të llixhave). Në Shqipëri, Elbasani duhet të konkurrojë me rajone të tjera bregdetare dhe rajone tashmë të njohura si destinacione malore. Krahas këtyre, prej shumë vitesh Elbasani ka krijuar imazhin e një qyteti të ndotur, ku aktivitetet kryesore të biznesit përqendrohen tek prodhimi industrial, jo tek shërbimet apo turizmi. Por jo gjithçka është gri nga perspektiva e Elbasanit si destinacion turistik. Duke qenë i vendosur në qendër të Shqipërisë e bën atë lehtësisht të aksesueshëm nga pikat kryesore të hyrjes në Shqipëri. Ai është gjithashtu i pasur me burime të mundshme turistike dhe ka një traditë të gjatë mikpritjeje, të cilat përbëjnë një bazë solide për ta kthyer Elbasanin në një destinacion karakteristik turistik.

Shumica e vizitave turistike në Elbasan lidhen me llixhat termale në Llixha (Tregan), me rreth 7 deri në 10 netë bujtje. Këto vizita janë aktive gjatë pranverës dhe vjeshtës kur moti është i favorshëm për trajtime shëndetësore termale. Shumica e vizitorëve janë nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia e Veriut. Fatkeqësisht, nuk ka statistika për numrin e saktë të hoteleve në Llixha (Tregan), numrin e turistëve që e vizitojnë zonën dhe numrin e bujtjeve.

Një tjetër destinacion që përfshin bujtje është Gjinari, destinacion malor që gjendet rreth 24 km nga Elbasani. Ndonëse njihet si një destinacion i bukur turistik, aty ofrohen numër i vogël aktivitetesh, që rezulton me atë që turistët të qëndrojnë jo më shumë se një deri dy ditë. Shumica e tyre bëjnë vizita njëditore, duke shijuar ushqimin e përgatitur në mënyrë tradicionale, ajrin e pastër dhe natyrën e mrekullueshme.

Elbasani njihet për organizimin e festës “Dita e Verës” që mbahet çdo vit më 14 mars, e cila është edhe festë kombëtare. Mijëra vizitorë vijnë atë ditë apo një ditë më parë për të shijuar ushqimin tradicional dhe për piknik në natyrë, duke krijuar një atmosferë festive në Elbasan dhe rrethinën në afërsi. Por kohëzgjatja e qëndrimit të turistëve nuk është më shumë se një natë, ndërsa shumica janë vizitorë njëditore.

Elbasani ka edhe shumë atraksione të tjera turistike, të cilat mund të përfshihen në ofertat turistike të agjencive apo operatorëve. Por potenciali i tij si destinacion turistik nuk është shfrytëzuar plotësisht, duke lënë shumë hapësirë për përpjekje dhe përmirësime. Në vitin 2007, Këshilli i Qarkut Elbasan përgatiti “Planin e Veprimit për Turizmin në Qarkun e Elbasanit”, i cili duhej të shërbente si një udhërrëfyes i përgjithshëm për zhvillimin e sektorit të turizmit në Elbasan. Megjithatë, nuk ka të dhëna statistikore ose informacione konkretet për ndikimin e Planit të Veprimit në zhvillimin e turizmit në Elbasan.



Një prej objektivave strategjike të përcaktuara në Strategjinë e Zhvillimit të Territorit të Bashkisë Elbasan (2015) është "... mbrojtja dhe rikuperimi i burimeve natyrore si element themelor i mirëqenies sociale dhe përmirësimit ekonomik, nëpërmjet turizmit natyror dhe kulturor". Kështu, pushtetet vendore dhe organet e tjera qeveritare janë të vetëdijshme për rëndësinë e turizmit dhe zhvillimin e tij. Megjithatë, akoma nuk ka plan veprimi për zhvillimin e turizmit në Elbasan, ashtu që proceset zhvillimore bazohen kryesisht në nisma private dhe ngjarjeve sporadike.

Autoritetet e bashkisë siguruan të dhëna të sakta për kapacitetet e objekteve hotelierike dhe numrin e vizitorëve gjatë çdo muaji apo stine të vitit në Elbasan. Këtë nuk e mundësoi as qeveria qendrore, as institucionet e tjera.

Për shkak të ndërvarësisë së tij me sektorët e tjerë të ekonomisë, zhvillimi i turizmit e mundëson zhvillimin e ekonomisë lokale. Nga ana tjetër, është mjaft sfiduese për të përcaktuar ndikimin e saktë ekonomik që turizmi si sektor e ka mbi ekonominë lokale. Përveç kësaj, analiza për të përcaktuar se cili investim është e pastër për turizmin është e ndërlikuar. Për shembull kur investohet në infrastrukturën rrugore ose shëndetësore, përfitimet janë të destinacionit në përgjithësi, në aspektin e qasjes dhe krijimin e zonat turistike më të aksesueshme dhe më të sigurta për t'u vizituar.

Investimet e projektit infrastrukturor KET në Krushevë dhe Elbasan kontribuojnë me të madhe në atraktivitetin e destinacioneve lokale për sa i përket aksesit në lokacionet aventuristike, duke nxitur zhvillimin e përgjithshëm ekonomik në zonën ndërkufitare, gjë që rezulton me më shumë vende pune, më shumë të ardhura dhe eksport më të madh të shërbimeve.

## II.2 ANALIZA E SITUATËS AKTUALE LIDHUR ME STRATEGJITË DHE POLITIKAT NË NIVEL LOKAL, RAJONAL DHE KOMBËTAR

Literatura e konsultuar (e paraqitur në tabelën 3 më poshtë) i vendos bazat për zhvillimin e mëtejshëm të destinacioneve lokale të Krushevës dhe Elbasanit. Përfshin prezantim të thellë të potencialit të destinacioneve vendore dhe drejtimeve të zhvillimit të tyre nga një këndvështrim strategjik. Dokumentet strategjike të nivelit kombëtar dhe lokal përputhen me tendencat aktuale të BE-së në zhvillimin e turizmit në përgjithësi. Disa aspekte specifike për destinacionin lokal (turizmi aktiv, turizmi i mirëqenies, turizmi rural) janë theksuar si karakteristikat më të fuqishme turistike për zhvillimin e mëtejshëm të destinacionit. Në tabelën më poshtë është një përmbledhje e planifikimit strategjik për zhvillimin e destinacionit të Krushevës dhe Elbasanit, përkatësisht.

**Tabela 3: literaturë e konsultuar**

	Organizata /institucioni	Strategjitë/Planet/Dokumentet e analizuar
1	Komuna (Bashkia) e Krushevës	<a href="#">Strategjia për Zhvillimin e Turizmit të Komunës së Krushevës 2020-2025</a>
2	Komuna (Bashkia) e Krushevës	<a href="#">Plani i integruar për zhvillimin lokal të komunës së Krushevës, 2019-2022</a>
3	Qendra për zhvillimin e rajonit të Pellagonisë	<a href="#">Programi për zhvillimin e rajonit të Pellagonisë 2021-2026</a>
4	Qendra për zhvillimin e rajonit të Pellagonisë	Studimi për zhvillimin e Pellagonisë si destinacion për turizëm aventuristik "Pelagonia – e formuar për aventurë"
5	Byroja për zhvillim rajonal të Maqedonisë së Veriut	<a href="#">Strategjia Kombëtare për Zhvillimin Rajonal 2021-2031</a>
6	Ministria e Ekonomisë e Maqedonisë së Veriut, sektori Turizëm	<a href="#">Strategjia Kombëtare e Turizmit të Republikës së Maqedonisë, 2016-2021</a>

7	Ministria e Ekonomisë e Maqedonisë së Veriut, sektori Turizëm Agjencia për promovim dhe përkrahje të turizmit në Republikën e Maqedonisë së Veriut	<a href="#">Strategjia Kombëtare për turizmin rural 2012-2017</a>
8	LRCP	<a href="#">Planet e zhvillimit të turizmit për dhjetë destinacione në Maqedoninë e Veriut</a> <a href="#">Vëllimi 1 – Metodologjia, Sfondi dhe Analiza e Tregut, 2016</a>
9	LRCP	<a href="#">Planet e zhvillimit të turizmit për dhjetë destinacione në të gjithë Maqedoninë e Veriut</a> <a href="#">Vëllimi II – Planet për Zhvillim të Destinacioneve Nëntor 2016</a>
10	LRCP	<a href="#">Plani Zhvillimor Nr.3 Destinacioni Pellagonia, 2017</a>
11	Ministria për Vetëqeverisje Lokale, Maqedonia e Veriut	<a href="#">Programi IPA CBC Republika e Maqedonisë së Veriut - Republika e Shqipërisë 2014-2020</a> <a href="#">Programimi IPA III CBC 2021-2027 ndërmjet Maqedonisë së Veriut dhe Shqipërisë</a>
12	Bashkia Elbasan	<a href="#">Strategjia e Zhvillimit të Territorit të Bashkisë Elbasan</a>
13	Bashkia Elbasan	Plani Strategjik i Zhvillimit të Qytetit të Elbasanit 2010 - 2020
14	Republika e Shqipërisë, Këshilli i Ministrave	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHII) 2015-2020
15	Ministria e Turizmit, Shqipëri	Strategjia për Zhvillimin e Turizmit në Shqipëri (2019-2023)
16	Ministria e Turizmit, Shqipëri	Programi i Integruar për Zhvillim Rural (IPRD) - Programi i 100 Fshatrave
17	Ministria e Ekonomisë, Republika e Maqedonisë së Veriut, sektori turizëm <a href="#">Agjencia për Promovimin dhe Përkrahjen e Turizmit në Republikën e Maqedonisë së Veriut</a>	Ligji për Turizmin
18	Ministria e Turizmit, Shqipëri	Ligji për turizmin
19	Sekretariati i Këshillit të Investimeve, Shqipëri	Kuadri Ligjor dhe Institucional për Turizmin, Shqipëri 2018
20	"Përtej kufijve – Prezantimi i turizmit të zgjuar dhe ekonomisë së përbashkët", projekt i financuar nga BE	Studimi i trashëgimisë natyrore dhe kulturore të rajonit të bashkëpunimit ndërkuftar
21		Studimi i për Turizëm të Qëndrueshëm në Rajonin Ndërkuftar
22	"Përtej kufijve – Aplikimi i turizmit të zgjuar dhe ekonomisë së përbashkët", projekt i financuar nga BE	Studimi për resurset që janë në Dispozicion Shërbimet Turistike dhe Potenciali Turistik në Rajonin Ndërkuftar

Krusheva është destinacion turistik unik, sepse posedon komplet mahnitës prej pesë elementësh turistikë: akses, akomodim, atraksione, aktivitetet dhe komoditetet (e elaboruara në detaje në seksionin II: Analiza e situatës). Siç citohet në [Strategjinë aktuale për Zhvillimin e Turizmit të Komunës së Krushevës 2020-2025](#) "Komuna e Krushevës pretendon të bëhet një nga qendrat më të vizituara të destinacioneve turistike, si në Maqedoninë e Veriut, ashtu edhe më gjerë në Ballkan dhe Evropë. Për këtë arsye kjo Komunë u përfshi në një sërë projektesh në fushën e turizmit, ndërsa **synimi përfundimtar është zhvillimi i turizmit aventuristik** me të

*cilin qyteti mund të kthehet në një destinacion të vizituar gjatë gjithë vitit*". Që Krusheva të arrijë këtë qëllim, vetëqeverisja lokale ndërmoi një proces me pjesëmarrje të gjerë për të përcaktuar potencialin më të madh dhe për të vendosur veprime dhe hapa konkretë për zhvillimin e destinacionit, duke punuar së bashku me sektorin privat dhe atë civil.

Për më tepër, Krusheva njihet si "**destinacion aventuristik me peshë**" (Krusheva, Prilepi dhe rrethina) ku ka dëshmi të mjaftueshme të tregut për aftësinë konkurruese në nivel ndërkombëtar të kushteve dhe infrastrukturës për paraglajding. Sipas analizës së detajuar në kuadër të nën-projektit LRCP i financuar nga BE-ja, kurse i implementuar nga Banka Botërore, "*rritja në këtë segment, si dhe diversifikimi i ofertës së aventurës së vështirë me aktivitete të tjera si ngjitja në shkëmbinj, bouldering dhe të tjera, ka potencial shumë të fortë për të krijuar mundësi të reja biznesi dhe vende të reja pune me kualifikim të lartë*" ([Plane për zhvillim të turizmit për dhjetë destinacione në Maqedoninë e Veriut Vëllimi II – Plane për zhvillim të destinacioneve, nëntor 2016](#)). Analiza e mësipërme konkludon se strategjikisht Krusheva duhet të fokusohet në zhvillimin paralel të ofertave shtesë që nuk janë të lidhura drejtpërdrejt me "aktivitetin thelbësor aventuristik së vështirë". Destinacioni gjithashtu mund të rrisë atraktivitetin me aktivitete që lidhen me trashëgiminë kulturore dhe aktivitete të buta aventuristik që përfshijnë përvojat lokale ndërveprimin më të lartë me popullatën lokale, duke e paraqitur origjinalitetin e qytetit dhe kështu i përfshijnë të tre aspektet e udhëtimit aventuristik sipas përkufizimit ATTA (aktiviteti fizik, mjedisi natyror dhe zhytja kulturore).

Strategjia kombëtare për zhvillimin e turizmit të Maqedonisë së Veriut thotë **se tregu më i madh për vendin si destinacion janë vizitorët vendas**, që përbëjnë më shumë se 50% të vizitave me qëndrim mesatar prej 5+ ditësh. Këta shifra duhet të rishikohen ende nën dritën e pasojave nga COVID 19 pasi preferencat e udhëtimit, sipas të dhënave, u zhvendosën në më shumë udhëtime në vende të hapura, natyrë dhe "destinacione të gjelbra". Krusheva i ofron të gjitha që u përmendën më sipër, duke u plotësuar me aktivitete kulmore aventuristike dhe duke përfshirë aktivitete tematike për tërë familjen, siç është Parku i Aventurës i sapohapur në Staniç dhe 40+ km shtigje të shënuara për biçikleta, duke siguruar ofertë aventuristike në më shumë stinë (e elaboruar në seksion III.5 AKTIVITETET). Strategjia Kombëtare sugjeron hapa konkretë për promovimin e destinacionit, vendit në tërësi, duke përfshirë edhe krijimin e DMO-ve rajonale (organizata për menaxhim të destinacioneve) përgjegjëse për zhvillimin e destinacionit lokal së bashku me ndërtimin e vazhdueshëm të kapaciteteve të ofruesve të turizmit dhe organizatat në nivel të politikave. Transferimi i njohurive theksohet si parakusht vendimtar për zhvillimin e mëtejshëm të destinacionit.

[Programi për zhvillimin e rajonit të Pellagonisë 2021-2026](#) vë në pah se ekziston një trashëgimi e llojllojshme shumë e pasur kulturore dhe historike, nga të cilat lokaliteti arkeologjik Heraklea, arkitektura e Manastirit dhe **arkitektura tradicionale e Krushevës**, si dhe kishat e shumta, manastiret, muzetë, njësitë memoriale urbane dhe rural si dhe lokalitete të shumta natyrore, që përfaqësojnë një potencial jashtëzakonisht të madh për zhvillimin e llojeve të ndryshme të turizmit (liqenor, malor, religjioz, rural etj.) dhe përmirësimin e ekonomisë në rajon.

Pjesa e turistëve të huaj që i takon Pelagonisë bie ndërmjet **3-4% të numrit të përgjithshëm të bujtjeve në Maqedoninë e Veriut** duke llogaritur gjashtëmuorin e parë të vitit 2022. Kjo dëshmon tendencat globale të rënies së udhëtimeve në dalje pasi Pellagonia ka shënuar deri në 7% të vizitave të të huajve deri në vitin 2019. Për shembull, në qershor 2022, Maqedonia e Veriut numëronte 115 351 bujtje nga vizitorë të huaj, ndërsa Pellagonia ka numër modest prej 4366.

**Tabela 4: Numri i bujtjeve të turistëve të huaj në Maqedoninë e Veriut**

2022M01	2022M02	2022M03	2022M04	2022M05	2022M06
1 301	1 298	2 158	2 033	4 082	4 366

Burimi: Baza e të dhënave MAKSTAT, gusht 2022

Shqipëria vlerësohet nga shumë operatorë dhe vizitorë ndërkombëtarë për natyrën dhe peizazhet e saj të bukura. Zonat natyrore dhe rurale në Shqipëri ofrojnë mundësi për zhvillimin e turizmit rural, turizmit malor, ekoturizmit dhe aktiviteteve në natyrë (rafting, paraglajding, fluturim, çiklizëm malor, peshkim, alpinizëm, kalërim, udhëtime studimore, etj.).



Zhvillimi i turizmit malor rezultoi në stabilizimin e një numri të konsiderueshëm turnesh të organizuara në Theth, Vermosh-Lepushë, Valbonë dhe Tropojë, në Alpet Shqiptare, zonën e Dibrës dhe Bulqizës, në zonën malore në rrethinën e Tiranës, Elbasanit dhe Librazhdit, në zonën malore të Korçës, mali i Tomorit, Llogarasë dhe Karaburunit dhe rajoni malor i Gjirokastrës e Përmetit. Nga ana tjetër, kategorisë turizëm malor i shtohet edhe turizmi në zonat e mbrojtura ekologjike. Kjo kategori përfshin disa forma të turizmit, si agroturizmi, turizmi i konferencave dhe biznesit, turizmi kulturor (trashëgimia kulturore-historike, turizmi religjioz etj.), turizmi eno-gastronomik dhe turizmi shëndetësor (i llixhave). Nga studimet e ndryshme të realizuara me vizitorët dhe industrinë e turistike nga tregjet e huaja, rezulton se arkeologjia, trashëgimia dhe kultura janë identifikuar si pikat e forta të Shqipërisë dhe qëllimi kryesor i vizitave. Destinacionet kryesore që turistët i vizitojnë gjatë turneve organizuara kulturore janë Shkodra, Lezha, Kruja, Durrësi, Tirana, Fieri, Berati, Elbasani, Korça, Përmeti, Gjirokastra, Saranda dhe Vlora.

Për të nxitur zhvillimin rural, qeveria shqiptare realizoi një projekt ambicioz të quajtur "100 fshatrat", i cili ndikoi pozitivisht në zhvillimin e turizmit në këto rajone. Ky projekt synonte të koordinojë përpjekjet për zhvillim në hapësirat rurale të 100 fshatrave në Shqipëri, duke lënë pas ndërhyrjet e pjeshme dhe qasjet sektoriale të fokusuara ngushtë. Objektivat kryesore ishin përmirësimi i infrastrukturës publike, diversifikimi i aktiviteteve ekonomike (duke përfshirë përmirësimin e potencialit turistik në zonat rurale) dhe zhvillimin e kapitalit social dhe njerëzor. Pjesë e këtij projekti ishin dy fshatra të Bashkisë Elbasan, gjegjësisht Shushica dhe Gjinari. Megjithëse ekziston një opinion përgjithësisht pozitiv për ndikimin që ka pasur ky projekt në zhvillimin e turizmit rural në dy fshatrat e kualifikuara të Elbasanit, nuk ka të dhëna zyrtare që ta mbështesin këtë. Nuk ka bazë të dhënash që i përfshin të gjithë aktorët e këtij projekti, kurse ndikimi i investimeve nuk është matur ([revista "Monitor" për Raportin e Institucionit të Kontrollit të Lartë Shqiptar, për Projektin "100 fshatrat"](#)).

Administrata e Bashkisë së Elbasanit është aktori kryesor që i koordinon dhe i harton politikat e turizmit në nivel lokal, në përputhje me [Strategjinë Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit](#). Ka përpjekje për të promovuar Elbasanin si destinacion turistik, duke i evidentuar atraksionet kryesore të tij dhe duke organizuar disa evente e festa gjatë vitit. Bashkia nuk ka drejtori të dedikuar për turizmin; ekziston një "Drejtori për Politikën në Trashëgiminë Kulturore, Turizëm, Art dhe Sport", që e përfshin aktivitetet për zhvillimin e turizmit. Detyra për promovimin e aktiviteteve turistike për rritjen e numrit të vizitorëve dhe për hartimin e implementimin e politikave për zhvillim të turizmit është caktuar t'i takojë një drejtorie tjetër, përkatësisht "Drejtoria e Përgjithshme e Politikave Sociale dhe Strategjike, Shërbimeve Komunitare dhe Inovacionit".

Sipas [Strategjia për zhvillimin e territorit të Bashkisë Elbasan](#), Elbasani ka potencial të mirë për zhvillimin e turizmit ekologjik, në natyrë, agro-turizmit, shëndetësor, malor dhe turizëm historik-kulturor. Disa nga projektet që planifikohet të përgatiten janë (i) një hartë e plotë me vlerat historike të Bashkisë Elbasan; (ii) identifikimi i nevojave për ndërhyrje restauruese në vlerat historike dhe hartimin e projekteve teknike përkatëse; (iii) përmirësimi i infrastrukturës rrugore për destinacionet kryesore turistike në Bashkinë Elbasan.

Bashkia e Elbasanit e ka promovuar dhe e ka mbështetur çdo aktivitet që ka të bëjë me turizmin, veçanërisht ato që lidhen me destinacione specifike, si festat tradicionale të organizuara në Funar, Byshek dhe Gjinari.





### III. ANALIZA E SITUATËS

#### III.1 GJURMA KYÇ E DESTINACIONIT

Krusheva është vendi më i lartë në Ballkan i banuar, në një lartësi mbidetare prej 1350 m me pamje nga fusha e Pellagonisë nga njëra anë dhe nga zona malore e Demir Hisarit nga jugperëndimi. Është mesatarisht afër qyteteve më të mëdha në rajon, 32 kilometra në perëndim të Prilepit dhe 52,5 kilometra në veri të Manastirit. Ndodhet në pjesën jugperëndimore të vendit në zonën administrative të Pellagonisë, ndërsa në territorin e komunës ka 8.385 banorë. Për shkak të përbërjes së saj multikulturore, në Krushevë dy gjuhë janë zyrtare: maqedonishtja dhe arumunishtja, gjuhë që e flasin mbi 20 përqindjet e banorëve të Krushevës, me përkatesi etnike vllehe.

Krusheva dhe rrethina e tij, si destinacion, ka një portofol të pasur resursesh të bazuara në natyrën e larmishme dhe të ruajtur mirë dhe në trashëgiminë e dalluar kulturore materiale dhe jomateriale. Atraksionet kryesore të zonës përfshijnë si atraksionet natyrore ashtu edhe ato të ndërtuara, siç është monumenti Makedonium (Memoriali Ilinden), Shtëpia Përkujtimore e Toshe Proeskit, pista për paraglajding dhe fluturime, vende për bouldering dhe ngjitje në shkëmbinj, arkitekturë autentike dhe të ruajtur mirë, park aventuristik, terrene për skijim dimëror, shtigje për çiklizëm, shtigje për hiking dhe trekking, kuzhinë lokale, si dhe peizazhe specifike për shkak të vendndodhjes së saj unike.

Faktorët më të njohur tërheqës të Krushevës janë natyra e ruajtur dhe e pastër, aktiviteti aventuristik i paraglajdingut dhe roli i tij unik në historinë e popullit maqedonas. Në Krushevë në vitin 1903 u themelua republika e parë në Ballkan – Republika e Krushevës (gjatë kryengritjes së Ilindenit kundër Perandorisë Osmane).

Përveç si destinacione për fundjava, për vizitorët vendas të cilët shijojnë ajrin e pastër dhe më të freskët gjatë verës për shkak të pozitës më të lartë të Krushevës, gjithashtu shumë kompani po e vizitojnë këtë destinacionin për team-building aktivitete shkak të ofertës së aktiviteteve të buta dhe të forta për adrenalinë në natyrë. Komuna, në bashkëpunim të ngushtë me sektorin privat dhe komunitetin e donatorëve të huaj në katër vitet e fundit, ka zhvilluar mbi 40 km shtigje për çiklizëm që ua zbulojnë turistëve pyjet e Krushevës.





Parku aventuristik dhe i adrenalinës, i përshtatshëm për familjet dhe grupet, është shembull se si investimi privat e ka ndjekur qasjen strategjike për zhvillim që Krusheva të bëhet një destinacion aventuristik, duke kontribuar kështu në atraktivitetin e përgjithshëm të destinacionit.

Qeveria dhe investitorët privatë bënë investime të shumta që Krusheva sërish të kthehet në një destinacion dimëror dhe të ofrojë pista skijimi për fillestare deri në ato në nivele mesatarë, duke përfituar nga klima e favorshme që ka Krusheva dhe mundësia për të garantuar skijim në çdo sezonë.

Në 5+ vitet e fundit sinonimi i Krushevës ka qenë paraglajdingu. Pavarësisht nëse e dini destinacionin për shkak të angazhimeve profesionale në paraglajding ose thjesht në nivelin e ndërgjegjesimit për destinacionin për paraglajding, Krusheva është bërë lokacion kulmor për paraglajding. Përkatësisht, këtu organizohen dhe mbahen dhjetra gara dhe kampionate me paragliderë nga e gjithë bota, duke e vendosur Krushevën në vendet më të mira në mbarë botën për këtë aventurë të vështirë. Sa i përket turizmit, paraglajdingu është kthyer në produktin turistik më tërheqës të destinacionit pasi klubet e paraglajdingut janë kaluar nga pasioni për sport në biznes dhe tani ofrojnë tandem fluturime në paraglajding për të gjitha llojet e vizitorëve.

Qyteti i Elbasanit ndodhet në Fushën e Elbasanit, në lartësi prej 120 m mbi nivelin e detit. Qyteti është i rrethuar nga ullishte dhe kufizohet nga lumi Shkumbin dhe përrenjtë e Zaranikës dhe Manazderës.

Qyteti ka një sipërfaqe prej rreth 793 hektarë dhe është rreth 57 km nga Aeroporti i Tiranës "Nënë Tereza", 76 km nga Porti i Durrësit, 61 km nga pika kufitare e Qafë Thanës me Republikën e Maqedonisë së Veriut, si dhe 148 km nga pika kufitare e Kapshticës me Greqinë. Elbasani ka një pozitë gjeografike shumë të favorshme, që e lehtëson shkëmbimin ekonomik me rajonet e tjera në Shqipëri dhe vendet fqinje.

Lartësia e qytetit, mbi nivelin e detit, shkon duke u zvogëluar nga veriu në jug me rreth 35 metra mbi nivelin e detit. Elbasani është pjesë e zonës kodrinore mesdhetare, kurse larmia e formave të tij tokësore dhe shtrirja veri-jug kontribuojnë në regjimin e elementeve klimatike. Temperatura mesatare lëvizin nga 6,7°C në janar në 23,4°C në korrik. Era është një element dallues klimatik i Elbasanit, me një shpejtësi mesatare nga 1,2 m/s gjatë verës deri në 2,4 m/s në dimër. Reshjet mesatare vjetore janë 1148 mm, ku rreth 66% e tyre bien gjatë gjysmës së dytë të vitit. Reshjet e borës janë një fenomen i rrallë në Elbasan dhe mesatarisht nuk zgjasin më shumë se 1 deri në 2 ditë në vit.

Bashkia e Elbasanit e përfshin qytetin e Elbasanit, i cili ka gjashtë qarqe administrative (të shënuara nga 1 deri në 6) dhe 12 njësi administrative (p.sh. rajone rurale): Bradashesh, Gracen, Gjinar, Zavalinë,

Shushicë, Shirgjan, Paper, Gjergjan, Labinot-Fushë, Labinot- Mal, Tregan dhe Funar.

Sipas të dhënave të Bashkisë Elbasan, për vitin 2020, popullsia totale është 214 361 banorë: 61,5% ose 131 749 banojnë në 6 qarqe administrative të qytetit të Elbasanit dhe 38,5% ose 82 612 banojnë në 12 njësi administrative të Bashkisë Elbasan.

Zona e Elbasanit tashmë është identifikuar si një destinacion i rëndësishëm turistik falë vlerave të larmishme turistike të përhapura në të gjithë rajonin. Rreth 100 monumente të trashëgimisë historike dhe kulturore, rreth 80 monumente natyrore, 37 lloje veshjesh popullore dhe folklor i larmishëm, me produkte bujqësore bio, që janë më të kërkuara në ditët e sotme, me kuzhinën tipike të rajonit dhe veçanërisht me mikpritjen tradicionale, përfaqësojnë një destinacion turistik edhe për vizitorët vendas dhe për të huajt, që ndikojnë në zhvillimin e këtij sektori me rëndësi rajonale dhe kombëtare.

Shumëllojshmëria e vlerave historike, kulturore, arkeologjike, natyrore dhe malore përbëjnë një spektër shumë gjerë të llojeve të turizmit në qarkun e Elbasanit.

Për sa i përket cilësisë, përvojave - atraksioneve - produkteve - shërbimet e ofruara në destinacionin tematik janë të një cilësie të ndryshueshme, ka treguar analiza e situatës aktuale pas hulumtimeve në terren me aktorë lokalë lidhur me turizmin. Konkretisht, vlerësimi i nivelit të cilësisë sipas **5 A-ve: aksesit, akomodimit, atraksionet, aktivitetet dhe komoditetet** e një destinacioni, nuk mund të barazohet me një etiketë të përbashkët, sepse të dyja zonat ndryshojnë shumë kur bëhet fjalë për elementët e destinacionit.

Konkretisht, Krusheva llogaritet si mesatarisht i aksesueshëm, me akomodim autentik, atraksione unike, aktivitete të reja dhe komoditete bashkëkohore, ndërsa Elbasani llogaritet gjithashtu lehtësisht i aksesueshëm, me akomodim modern në vend të atij autentik, aktivitete bazë tipike dhe aventuristike dhe komoditete bashkëkohore.

Më poshtë, këto pesë elemente të një destinacioni janë analizuar veçmas, duke ofruar gjendjen e zhvillimit të procesit të vazhdueshëm të zhvillimit të turizmit në destinacionin tematik të Krushevës dhe Elbasanit.

## III.2 INFRASTRUKTURA KYÇE /AKSESI

**Tabela 5: pikat e aksesit deri te destinacioni**

	<b>Produkti/Shërbimi</b>	<b>Pse është element kyç?</b>	<b>Përshkrimi</b>
1	Aeroporti Ndërkombëtar në Shkup, Maqedonia e Veriut	Ofron +12 fluturime në ditë nga më shumë se dhjetë linja ajrore të ndryshme	Porta kryesore për të ardhje të fluturimeve ndërkombëtar për të hyrë në Maqedoninë e Veriut, +2.300.000 pasagjerë në vitin 2019
2	Aeroporti Ndërkombëtar në Ohër, Shën Pali, Maqedonia e Veriut	Siguron + 5 fluturime në ditë	Pika hyrëse për udhëtarët ndërkombëtarë në qytetet brigjet e Liqeni të Ohrit dhe Prespës në Maqedoninë e Veriut, + 317.000 pasagjerë në vitin 2019, dhe me rëndësi të madhe për mbërritjet në pjesët veriore të Shqipërisë për shkak të afërsisë me të dy pikat e kalimit kufitar ndërmjet Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut
3	Aeroporti Ndërkombëtar në Tiranë, Nënë Tereza, Shqipëri	Siguron +15 fluturime në ditë	Është aeroporti i vetëm në Shqipëri dhe i 8-ti më i frekuentuari në Ballkan, duke ofruar udhëtim ajrore për më shumë se + 3.350.000 pasagjerë në vitin 2019. Porta për të gjithë turistët ndërkombëtarë që vizitojnë destinacionin
4	Autostrada Shkup-Kërçovë E65-R1306 Krushevë	Rruga kryesore që përzgjidhet gjatë udhëtimeve nga kryeqyteti Shkupi në zonën e Krushevës	E rëndësishme si për vizitorët vendas dhe ndërkombëtarë. E lidh Aeroportin e Shkupit me Krushevën dhe gjithashtu kryeqytetin Shkupin (+600.000 banorë) me Krushevën.
5	Autostrada Shkup-Veles E75- A1;A3; R1001;R1306 – Krushevë	Rruga e dytë që përzgjidhet për të mbërritur në zonën e Krushevës, veçanërisht nëse vizita është pjesë e vizitës në qendrat e tjera në rajonin e Pellagonisë si Manastiri apo Prilepi.	E lidh kryeqytetin Shkupin dhe qytetet qendrore të Maqedonisë së Veriut, Velesin, Prilepin dhe Manastirin me destinacionin e Krushevës.
6	Elbasan- Strugë - Ohër- Krushevë	Rrugë qarkore dhe pikë e hyrjes nga Shqipëria/Pika e kalimit Qafë Thanë në drejtim të Maqedonisë së Veriut]]ut	E rëndësishme si për udhëtarët vendas ashtu edhe për ata ndërkombëtarë pasi i lidh Krushevën dhe Elbasanin me aeroportin e Shën Palit dhe qytetet në brigjet e liqenit, Ohrin dhe Strugënn me Krushevën dhe Elbasanin. Është gjithashtu një rrugë që lidh destinacionin përmes pikëkalimit kufitar ndërmjet Maqedonisë së Veriut - Shqipërisë (Qafë Thanë). Gjithashtu, vozitja më e shkurtër e mundshme nga Krusheva në Elbasan dhe anasjelltas, për të kaluar 200 km për katër orë vozitje.
7	Tiranë-Elbasan-Strugë- Krushevë	Rrugë qarkore dhe pikë e hyrjes nga Shqipëria/Pika e kalimit Qafë Thanë në drejtim të Maqedonisë së Veriut.	Një nga lidhjet kryesore rrugore midis Elbasanit dhe Krushevës, që mundëson akses deri te destinacioni për udhëtarët ndërkombëtarë dhe vendas për shkak të aeroportit në Tiranë. Është opsion më i gjatë i vozitjes për nga kohëzgjatja nga Shqipëria në Maqedoninë e Veriut dhe anasjelltas, +6 orë.




Infrastruktura e aeroporteve në të dy aeroportet është e re dhe e mirëmbajtur, me një numër në rritje të fluturimeve dhe destinacioneve të linjave ajrore prej – në, çdo vit. Gjithashtu, të dy aeroportet punojnë me kompani ajrore me kosto të ulët për të ofruar akses të lehtë dhe të përballeshëm deri te destinacion.

Aeroportet e TAV në Shkup dhe Aeroporti Ndërkombëtar Shën Pali në Ohër në Maqedoninë e Veriut, që i shërbejnë destinacionet kryesore nga r përfshijnë të gjitha qytetet më të mëdha brenda BE-së, Turqisë dhe Lindjes së Mesme. Siç paraqitet më poshtë në figurën 5, të gjitha ato lidhen me fluturime direkte.

Krahas Aeroportit Ndërkombëtar Nënë Tereza në Tiranë, Shqipëria e ka hapur edhe aeroportin e dytë në Kukës, në pjesën veriore të vendit, afër kufirit me Kosovën. Lokacioni i aeroportit të ri do t'u shërbejë qyteteve jo-bregdetare dhe pjesën kontinentale të Shqipërisë, dhe është në një distancë më pak të favorshme nga Elbasani dhe Krusheva. Prandaj Aeroporti në Kukës nuk konsiderohet si një pikë kyçe aksesit deri te këto destinacione.


**Figura 1: fluturime direkte prej – deri në aeroportet ndërkombëtare në Shkup (majtas) dhe Tiranë, Shqipëri (poshtë) dhe Ohri (i fundit në fund), Maqedonia e Veriut**



Përsa i përket infrastrukturës rrugore, përveç seksioneve të rrugëve që janë autostrada, niveli i infrastrukturës rrugore klasifikohet si rrugë rajonale ose lokale (ju lutemi shikoni shënimin e rrugëve të paraqitur në figurën 2 ku prefiksi E qëndron për autostradë, R për markat e kufizuara dhe të tjera kombëtare që janë për infrastrukturën lokale).


Në këtë aspekt, mirëmbajtja dhe cilësia e rrugëve prej – deri në Krushevë dhe Elbasan janë të një cilësie të moderuar. Seksionet e rrugës që mbajnë shenjën e autostradës janë më cilësore sipas obligimit të autoritetit publik kombëtar për infrastrukturën rrugore për mirëmbajtje të rrugëve në një nivel të caktuar të cilësisë.

**Figura 2: lidhjet rrugore me qendrat në destinacionin Krushevë-Elbasan**



Konkretisht, të ardhurit vendas dhe ndërkombëtarë të Aeroportit në Tiranë ose nga kontinenti i Shqipërisë dhe Shkupit do të kenë akses rrugor cilësor, në nivel të autostradës deri në Elbasan në Shqipëri gjegjësisht Gradsko/Ohër në Maqedoninë e Veriut. Duke hyrë në Maqedoninë e Veriut në drejtim të Strugës ose duke hyrë në Shqipëri në drejtim të Elbasanit në pikën e kalimit kufitar në Qafë Thanë, pasagjerët do të vazhdojnë udhëtimin përmes rrugëve rajonale që janë me cilësi mesatare.

**Figura (majtas) 3: rrjeti i mundshëm rrugor për rreth e përqark, që e lidh Krushevën dhe Elbasanin si pjesë e një udhëtimi më të madh ballkanik**



Për sa i përket udhëtimit rreth e përqark, vizita e të dy pikave qendrore të destinacionit përmes të njëjtës pikë hyrëse/përfundimtare të udhëtimit, Shkupi apo Tirana, madje edhe Ohri, për turistët ndërkombëtarë apo vizitorët nga kryeqytetet Evropiane, turistët mund të shijojnë një turne ballkanike me paketën e qëndrueshëm për udhëtim aventuristik.

Një avantazh shumë i rëndësishëm i aksesueshmërisë në destinacion është mundësia për të kaluar kufirin mes dy vendeve përmes dy pikave të ndryshme dhe për të vizituar tre vende për udhëtim, duke e përfshirë edhe Kosovën. Me këtë zgjerohet territori që vizitohet përgjatë rrugës midis dy qendrave të destinacionit dhe e shton vlerën e udhëtimit duke i ofruar turistit një eksplorim të dy vendeve në tërësi, e jo vetëm të pikave qendrore. Në të njëjtën kohë, vështrimet në të njëjtën kohë përputhen me imazhet e destinacionit në aspektin e natyrës, gjelbërimit dhe ngjyrës kaltër, gjegjësisht male dhe liqene.

Në Krushevë nuk ka transport të organizuar lokal. Objektet e akomodimit mund të organizojnë lehtësisht transport, pasi ekzistojnë shumë shërbime të transportit privat dhe janë lehtësisht të aksesueshme. Shumica reklamojnë në vendet e akomodimit dhe mund të kontaktohen përmes telefonit ose online. Kostoja e transportit lokal është shumë e ulët.



### III.3 AKOMODIMI


Një portofol i moderuar akomodimi e karakterizon Krushevën me dy hotele më të mëdha, [Montana](#) dhe [Panorama SPA](#) si dhe [Vila Gora](#) e sapo zgjeruar dhe shumë objekte të vogla për fjetje dhe mëngjes në pronësi të familjeve (një pjesë e konsiderueshme e të cilave janë joformale dhe nuk mund të rezervohen në internet) që arrijnë gjithsej 1250 shtretër që dallojnë për nga niveli i cilësisë. Shjumëllojshmpria e kapaciteteve akomoduese është një avantazh i madh, sepse mundëson destinacionin për lloje të ndryshme të turizmit sipas preferencave të mysafirëve, duke përfshirë udhëtimet korporative, për pushime dhe kohë të lirë, si dhe udhëtime kulturore dhe aventuristike.

**Tabela 6: disponueshmëria e shtretërve, Krushevë**

Hotele/ kapacitete akomoduese	Numri i shtretërve
<a href="#">Hotel Montana</a>	220
<a href="#">Hotel Panorama SPA</a>	70
Hotel Ilinden – në rikonstruksion	150
Resorti për fëmijë Begova Koriija (Shula Mina)	150
Objektet akomoduese private	580
Konaqet e Manastireve	80
<b>Totali në destinacion</b>	<b>1 250</b>

Hulumtimi në terren i dha shifrat e mësipërme me vërejtjen se objektet private të akomodimit po rriten vazhdimisht duke e ndjekur anën e kërkesës nga tregu turistik. Megjithatë, shumë nga shtëpitë që ofrojnë akomodim mbeten të paregjistruara në Komunë, ashtu që vlerësimin e totalit të shtretërve në dispozicion në Krushevë është një vlerësim.

Për sa i përket stilit, mund të gjenden të gjitha llojet e akomodimeve, nga tradicionale në moderne, me estetikë të përgjithshme që mbizotëron në arkitekturën autentike të Krushevës. I njëjti stil është përkthyer edhe në arkitekturën bashkëkohore të dy hoteleve kryesore në Krushevë, Montana dhe Panorama. Të dy llojet e akomodimit, dhoma dhe apartamente, ofrohen për të mundësuar akomodim individual dhe në grup për objekt. Me ngritjen e platformave online për prenotim të akomodimit Booking.com dhe Airbnb.com, u mundësua shitja onlajn e akomodimeve, me prani të vazhdueshme të mbi 20 objekteve që ofrohen portalet onlajn, figura 3 më poshtë. Mesatarisht, kostoja e akomodimit, gjegjësisht bujtje me mëngjes për një person shkon nga 11 euro në një vila private deri në 70 euro për një dhomë teke në Hotel Panorama & SPA.



**Figura 4: Prania e Airbnb e kapaciteteve akomoduese në Krushevë**

Elbasani ka një traditë të gjatë në ofrimin e shërbimeve të mikpritjes për shkak të pozicionit të tij specifik në qendër të Shqipërisë dhe është pjesë e disa rrugëve kombëtare dhe ndërkombëtare. Disa lloje biznesesh ofrojnë këto lloj shërbimesh, megjithëse numri i tyre është i palakueshëm. Kështu, sipas të dhënave zyrtare të Bashkisë Elbasan (viti 2019), në Elbasan janë 70 biznese që ofrojnë shërbime akomodimi. Tridhjetë e nëntë prej tyre, ose 56%, janë hotele që gjenden në njësinë administrative Tregan, ku gjenden edhe burimet e njohura të ujit termal. Këto hotele u shërbejnë kryesisht të rriturve të moshuar që vijnë për qëllime terapeutike dhe nuk janë të preferuar prej turistëve të tjerë (për shkak edhe të erës së dyoksidit të sulfurit që lidhet me aktivitetin gjeotermal). Hotele të tjera, që gjenden kryesisht në qytetin e Elbasanit dhe rrethinë, ofrojnë vetëm shërbime akomodimi dhe kafe - bare. Vetëm disa prej tyre ofrojnë shërbime të restoranteve me gatimin e ushqimeve.

Për sa i përket vendbanimeve të afërta, shërbime akomodimi ofrohen vetëm në Gjinar (11), Shirgjan (1), Labinot (4), Qerret (1) dhe Funar (1).

Gjatë kërkimit në faqet e internetit që ofrojnë shërbime akomodimi shihet se ka disa biznese që ofrojnë shërbime të tilla. Kështu, në qarkun e Elbasanit janë shënuar këto lloje shërbimesh akomodimi: 14 apartamente, 12 hotele, pesë bujtina, katër shtëpi pushimi, dy vila, një hostel dhe bujtinë për fjetje me mëngjes.

Në vijim është një listë e objekteve akomoduese në Bashkinë e Elbasanit (pa përfshirë ato në Llixhe dhe Tregan, të cilat përdoren kryesisht për turistët që shkojnë atje për trajtim).

**Tabela 7: disponueshmëria e akomodimit në Elbasan**

Hotele/Kapacitete akomoduese	Nr. i shtretërve
Hotel Univers	60
Hotel Imperial	100
Hotel Grand	30
Hotel Ballkan	50
Villa Imperial	20
Hotel Monarch	20
Hotel Guri	30
Hotel Real Scampis	20
Hotel Le Olive	30
Resorti Kriva	110
Hotel Colombo	40
Objektet akomoduese private	300
Akomodim privat Deliu (Funar)	8
Kapacitete akomoduese private (Funar)	15
Tre Bujtinat (Gjinar)	20
Shtatë (7) bujtina (Gjinar)	75
Katër (4) hotele të vogla (Gjinar)	50
Kapacitete akomoduese private (Gjinar)	20
Total ne destinacion Elbasan	<b>998</b>

Siç u prezantua më lart, të dy destinacionet lokale mund të strehojnë njëkohësisht deri në 2250 vizitorë në lloje dhe nivele të ndryshme të objekteve cilësore akomoduese.

### III.4 ATRAKSIONET

**Faktorët më me ndikim për atraktivitet që ndërlidhen me udhëtimet aventuristike janë atraksionet dhe aktivitetet e destinacionit.** Pasi destinacioni Krushevë - Elbasan ndërlidhet me temën e atraksioneve të turizmit aktiv/aventuristik, që i motivojnë turistët të vizitojnë destinacionet lokale, të cilat përbëhen nga karakteristika apo ngjarje në natyrë dhe jonatyrore në territorin e të dy bashkive ose njëkohësisht në të dy rajonet.

Veçantia e Krushevës është një përzjerje e faktorëve atraktivë, duke përfshirë një grup unik të atraksioneve të ndryshme, prej atyre kulturore e deri te ato aventuristike. Nuk ndodh aq shpesh që ndonjë destinacion,



siç është Krusheva, të mund të ofrojë aktivitete turistike nga më të ndryshmet gjatë gjithë vitit. Për fat të mirë, pozicioni unik i Krushevës, në aspektin natyror ashtu edhe kulturor-historik, siguron atraksione të ndryshme për destinacion. Më poshtë janë paraqitur atraksionet kryesore të Krushevës, natyrore apo të ndërtuara.



### **“Ilinden” ose Makedonium** – kompleksi monumental në Krusheve

Monumenti Ilinden shtrihet në 12 hektarë dhe forma fillon me prangat e thyera, vazhdon përmes kriptës dhe skenës shumëngjyrëshe-mozaike qeramoplastike dhe përfundon me një kupolë të ngritur në 1320 metra mbi nivelin e detit, nga ku një pamje shumë e bukur në qytetin e Krushevës. Në brendinë e kupolës mbresëlënëse janë relievet, vitrazhet me flakën e përjetshme dhe tingujt e oratoriumit “Dielli i tokës së lashtë”. Monumenti e përfaqëson mosbindjen, luftën dhe përpjekjen e përhershme të popullit maqedonas për liri dhe shtet të pavarur.



**Dhjetë Ditët e Republikës së Krushevës** – Tradicionalisht, kjo ngjarje organizohet çdo vit, në fillim të gushtit, duke e lexuar Manifestin e Krushevës si pjesë e shënimit të kryengritjes së Ilindenit. Gjatë manifestimit, i tërë qyteti ndryshohet tërësisht në frymën e vitit 1903. Manifestimi fillon me pritjen ceremoniale të kalorësve të cilët tradicionalisht mbërrin në Krushevë para festës më të madhe maqedonase Ilindenit, për nder të luftëtarëve të rënë, të cilët kanë luftuar për Republikën e pavarur të Maqedonisë. Manifestimi e përfshin edhe ceremoninë e nxjerrjes dhe ngritjes së flamurit në shtyllën e Republikës së Krushevës, program kulturor-artistik, fishekzjarre dhe improvizim të shtënave me topin e qershisë.



**Shtëpia Përkujtimore e Todor Proeskit (majtas)** - E ndërtuar pas vdekjes për nder të yllit të madh të muzikës, është qendër që flet për jetën dhe veprën e artistit dhe është një nga atraksionet kryesore të qytetit.



**Shkritoja e plumbave (djathtas)** – Shkritoja është muze si memorial i Kryengritjes së Ilindenit. Është vendi origjinal ku janë bërë plumbat për kryengritësit gjatë Kryengritjes së Ilindenit.





**Pista për paraglajding** - Në afërsi të lokalitetit Meçkin Kamen (Shkëmbi i Ariut) është ndërtuar një nga vendet më të famshme në Ballkan për ngritje me paraglajder. Në Krushevë dhe Prilep ka klube dhe instruktorë të paraglajdingut, me të cilët mund të organizoni fluturime tandem mbi Pellagoni.



**Liçeni i Krushevës** - I quajtur ndryshe edhe Gumenje, është akumulim artificial pranë qytetit Krushevë, nga i cili rrjedh lumi Krushevë - Norovska. Ky liçen është një vend i mrekullueshëm për rekreacion, peshkim, apo thjesht për të shijuar natyrën, duke e plotësuar potencialin turistik të qytetit. Rrethina e liçenit përdoret për aktivitete në natyrë, vrapim ose ecje. Është një vend shumë i qetë i rrethuar me pisha. Nga viti 2018, për nder të Toshe Proeskit, në liçen ka filluar organizimi i një maratone tradicionale në not.



**Meçkin Kamen (Shkëmbi i Ariut)** – Disa kilometra larg qytetit, rruga të çon deri në lokalitetin ku janë zhvilluar beteja të ashpra gjatë Kryengritjes. Në Meçkin Kamen është ngritur përmendorja e Pitu Gulit, ku është shkruar slogabu “liri ose vdekje”.



**Manastiri “Sv. Preobrazenie” (Sh. Shpërfytyrimi)** Manastiri është ndërtuar me iniciativë dhe pjesëmarrje personale të njërit prej yjeve më të mëdha të muzikës në Ballkan, Toshe Proeski, i cili ka qëndruar shpesh në konaqet e Manastirit. Nga kompleksi i manastirit shihet panoramë e bukur e rrethinës.



**Galeria e Nikola Martinovskit** - Artdashësit do të gjejnë prehje të vërtetë mes veprave të piktorit bashkëkohor Nikolla Martinovski në galerinë e vendosur në një nga shtëpitë e Krushevës me stil autentik.



**Sportet dimërore** - Ski qendra e Krushevës është një nga vendet më të popullarizuara për skijim dhe, në përgjithësi, për turizëm dimëror në Maqedoninë e Veriut. Pjesë e qendrës së skijimit është vendi i quajtur Staniç ku ka disa pista skijimi për amatorë bashku me dy ski lifte. Është specifike se teleferiku fillon nga qendra e qytetit të Krushevës së





**Parku i aventurave** – parku aventuristik i përshtatshëm për fëmijë dhe të rritur, që ofron tre nivele vështirësish gjatë ngjitjes dhe ecjes nëpër litarët mes drunjve, zip-linja dhe shkëmbinj për boldering.



**Çarshia e Vjetër e Krushevës**- gjendet në qendër të qytetit, ku ka dyqane, restorante dhe shtëpi tradicionale me arkitekturë autentike. Rrugicat e ngushta ofrojnë relaks me një filxhan kafe ose vizita të monumenteve kulturore.



**Festivali në natyrë "Kur je në Krushevë"** -Qëllimi i festivalit është promovimi i bukurive të Krushevës dhe rrethinës së saj, mundësitë për sporte të adrenalinës dhe potencialin e Liqenit të Krushevës. Edicioni veror i festivalit zhvillohet në fillim të gushtit. Ai ofron përmbajtje të llojllojshme, si bjeshkatori, vrapim, pamje që nxisin adrenalinë me paraglajding tandem, çiklizëm të paharrueshme nëpër natyrën e Krushevës, argëtim dhe ngjarje të tjera. Festivali ka edhe edicionin dimëror, "Kur je në Krushevë – Dimri është këtu", i cili mbahet në fillim të shkurtit. Edicioni dimëror i festivalit ofron edhe përmbajtje interesante si një turne për fotografim, shëtitje rekreative, paraglajding tandem dimëror, kalërim dimëror mbi kuaj, degustim i specialiteteve të shijshme të Krushevës dhe argëtim të paharrueshëm.



**Arkitektura e qytetit të vjetër të Krushevës** - Shtëpitë janë të pavarura, kryesisht simetrike, pa hapësira të hapura tipike për qytetet e tjera në Maqedoni. Pjesa e pasme e shtëpive është e ndërtuar me gurë, ndërsa pjesa e përparme e të ashtuquajturave bondruk është konstruksion i shtyllave dhe trarëve prej druri të mbuluar me suvë të bardhë. Pothuajse gjithmonë ka një pus në pjesën e katit përdhësë. Në fasadën kryesore zakonisht ka dekorime të lyera me ngjyrë të kaltër. Ngjyra e kaltër përdoret tradicionalisht edhe për kornizat e dritareve dhe detaje të tjera të fasadave. Një ballkon i vogël në katin e sipërm zakonisht ka një pediment trekëndor sipër tij për të theksuar simetrinë e shtëpisë.





**Kuzhina tradicionale e Krushevës** është ende unike dhe origjinale, duke mbetur jashtë ndikimeve të kohës moderne. Receta më e njohur tradicionale e Krushevës është çomleku. Është një "tavë" mish viçi e pasuruar me specë, qepë, kumbulla blu, verë dhe erëza.



**Llokumi (djathtas)** - Është një ëmbëlsirë që prodhohet ndër breza në këtë qytet dhe ka cilësi të lartë. Llokumi me origjinë nga Krusheva është një privilegj vendor dhe, të paktën sipas historive lokale, nuk mund të gjendet në tjetër vend.



**Puslici/Celufki (puthje) (majtas)** - Një ëmbëlsirë që bëhet nga të bardhat e vezëve dhe sheqeri, tradicionale, krokante, e bardhë dhe e shijshme.

Elbasani për shkak të vendndodhjes së favorshme, klimës dhe destinacioneve të shumta me monumente historike, kulturore dhe natyrore është i pasur me resurse të ndryshme për zhvillim të turizmit.

**Rrapi i Bezistanit** - Ky resurs natyror ndodhet në qendër të qytetit dhe prej shekujsh ka shërbyer si qendër e ngjarjeve. Rrapi ka një trung të fortë dhe një shportë tipike. Menjëherë pranë tij ndodhet lokaliteti i madh arkeologjik, bazilika paleo-kristiane, mozaikë të zbuluar me ngjyra të bukura dhe punime artistike shumë të bukura.

**Kalaja e Elbasanit** - Kalaja e Elbasanit tërheq vëmendjen sapo dikush arrin në qendër të qytetit. Ka formë të drejtkëndëshit, 308 x 348 metra. Është rrethuar nga një hendek 4 metra i thellë, i cili furnizohet me ujë nga përroi i Zaranikës. Ka katër porta, që janë 40-50 metra nga njëra-tjetra, dhe 26 kulla mbrojtëse.

Pjesa romake e mureve mund të gjendet deri në 5 metra mbi themelet dhe është 3 metra e gjerë. Muret kanë pasur mure mbrojtëse që kanë shërbyer për qëllime të vëzhgimit dhe mbrojtjeje.

Muret e jashtme rrethuese shfaqin tre periudha kryesore nëpër të cilat ka kaluar kjo kështjellë: periudha romake, e hershme bizantine dhe osmane. Është një prej kështjellve më interesante në Ballkan, e ndërlidhet ngushtë me Via Egnatia.





**Bazilika e Bezistanit** -Pranë Rrapit historik shekullor të Bezistanit, ndodhet një bazilikë e lashtë që daton prej shekullit V. Në Bazilikë gjendet edhe një varr monumental, i mbuluar nga një mozaik dhe i vendosur rreth 30 metra nga muret e bazilikës. Bazilika ka vlera arkeologjike dhe artistike, siç janë mozaiku dhe afreskat e shumta. Ato janë kryevepra të artit figurativ, që e pasqyrojnë idenë për përjetësinë. Figurat në mozaik karakterizohen me motive të luleve, kafshëve dhe shpendëve, janë shprehje e mjeshtërisë së lartë për kohën kur janë krijuar. Mozaiku është dëshmi e trashëgimisë së madhe arkeologjike, si dhe dëshmi e zhvillimit të avancuar ekonomik dhe kulturor të Elbasanit në periudhën e Bizantit, periudhë prej kur daton Bazilika e Bezistanit.



**Kulla e Sahatit** -Kulla e Sahatit është ndërtuar mbi një nga kullat e kalasë, duke dominuar mbi sheshin kryesor të qytetit të Elbasanit. Kulla e sahati ka pasur disa rikonstruksione, e fundit që daton në vitin 1899. Ka bazë katrore 4,3 x 4,3 metra. Në harkun e portës jugore të kalasë është vendosur një pllakë mermeri që përshkruan e historinë e kullës: *"Nën kujdesin (patronazhin) e mbretit të botës (Sulltanit) Abdul Hamid Bujarit, u ndërtua kjo kullë gracioze e sahati. Burrat dinjitoz të Elbasanit e patën hirin ta ringjallën këtë sahat që e gëzon zemrën. Aqif Beu ka treguar kujdes dhe interesim të veçantë. Zoti i dhëntë gjithë të mirat e kësaj bote, sepse me tingujt e tij na e tregon kohën e saktë. Është ndërtuar në fillim të vitit 1315 (1899)".*



**Xhamia e Mbretit** - Kjo xhami ndodhet brenda Kalasë së Elbasanit. Siç del nga emri i saj, është një nga disa xhamitë e ndërtuara në fund të shekullit XV nga Sulltan Bajaziti II në territoret e pushtuara në Shqipëri. Çatia e tipike e xhamisë është prej druri, me një hajat para sallës për falje. Kjo xhami mund të jetë e vetmja faltore fetare në Shqipëri që është në harmoni të përsosur me mjedisin urban ku është ndërtuar.



**Muzeu Etnografik** - Ndodhet në qendër të qytetit, jo shumë larg Kalasë së Elbasanit. Ky muze është i vendosur në një shtëpi tradicionale dykatëshe të shekullit të 18-të që tregon për kulturën, folklorin dhe mënyrën e jetës në mesjetë. Muzeu që e rrëfen historinë për kulturën dhe stilin e jetesës së Elbasanit ndodhet brenda një prej shtëpive më tradicionale të qytetit. Muzeu e prezanton detajisht kulturën dhe folklorin e Shqipërisë së Mesme, zejet e asaj kohe, jetën e përditshme të qytetit dhe rrethinave të tij, si dhe mjetet kryesore të tregtisë së Elbasanit ndër vite.





**Xhamia Naziresha** -Kjo xhami tërheq vëmendjen e vizitorëve falë harmonisë dhe bukurisë së formave dhe ngjyrave të saj strukturore. Ajo daton nga fundi i shekullit XVI dhe është emëruar pas një gruaje shumë të respektuar nga popullsia e qytetit. Planimetria dhe përmasat e xhamisë e shprehin stilin klasik otoman të kohës kur ajo u ndërtua. Salla origjinale e faljes në formë katrore është ruajtur, ndërsa ka dëmtime të vogla në majen e minaresë.



**Kisha e Shën Mërisë** - Kisha ortodokse ndodhet në zemër të Kalasë së Elbasanit, pjesërisht e banuar nga popullata e krishterë ortodokse. Pamja e sotme e kishës daton nga vitet 1826-1833, kur është rindërtuar mbi rrënojat e një kisha të shekullit XVII që ishte djegur në vitin 1819. Pikturat me kube datojnë në vitin 1859. Përveç mjeshtërisë së lartë të drugdhendjes, kisha vlerësohet për bukurinë e saj arkitekturore, veçanërisht për arkadat e hajatit dhe gurët e gdhendur.



**Stacioni Ad Quintum** - Stacioni Ad Quintum është një pikë pushimi përgjatë rrugës antike Via Egnatia, e cila dikur e ka lidhur Romën me Kostandinopojën, e ndërtuar midis viteve 146 dhe 120 para Krishtit. Stacioni Ad Quintum ndodhet në Bradashesh, rreth 7 km nga Elbasani.



**Kisha e Shen Kollit** - Kjo kishë ndodhet në fshatin Shelcan, rreth 12 km nga Elbasani. Bazuar në karakteristikat e ndërtimit, besohet se është ndërtuar rreth fundit të shekullit XIV. Kisha është e zbukuruar me afreske piktoreske të ikonografëve mesjetarë Onufri dhe Kostantin Shpataraku.





### Embelsira tradicionale (Ballakume)

Të gjithë në Shqipëri e dinë se festat e verës janë të lidhura pashmangshmërisht me ballakumen, ëmbëlsirën tradicionale të qytetit, përgatitja e së cilës kërkon mjaft punë dhe kohë. Kjo ëmbëlsirë e shijshme është biskotë që bëhet nga miell i grurit ose i misrit dhe sasi të konsiderueshme të sheqerit. Në të vërtetë, shija she ëmbëlsia e saj, gjatë kohës, është bërë simbol i Festivalit "Dita e Verës". Përgatitja e ballakumes, megjithatë, është një sfidë e vërtetë pasi duhet përmbajtur me besnikëri recetës dhe çdo përbërës të shtohet me kujdes. Tradicionalisht përzierja e përbërësve bëhet me lugë druri në një enë bakri.



### Elbasan Tavë (Tavë me mish dhe kos)

Receta e këtij ushqimi të shijshëm veror e ka origjinën nga Elbasani, por tashmë shërbehet në të gjithë vendin. Një nga sekretet e Elbasan Tavës Kosit është se gatuhet vetëm me mishin e bagëtive të reja. Sekretit tjetër qëndron në marinimin e mishit me një sërë erëzash barishtore. Mishi fillimisht piqet vetë në furrë në mënyrë që të lëshojë të gjithë lëngjet e tij, me çka sigurohet që mishi të zbutet. Më pas, mbi mish dredhet një përzierje e trashë me vezë, mielli dhe një sasi të konsiderueshme e kosit të freskët dhe krejt kjo piqet sërish. Freskia e thartë e kosit e thekson ëmbëlsinë e mishit të qengjit duke rezultuar me një porcion të shijshëm që shkrihet në gojë.

## II.5 AKTIVITETET

Aktivitetet që ofrohen në këtë lokacion janë forcat kryesore motivuese për të vizituar një destinacion aventuristik dhe energjik. Vlera e tyre turistike është e madhe nga pikëpamja e diversitetit apo ekskluzivitetit. Gjithashtu, aktivitetet e destinuara për profesionistët dhe atletët mbështeten me respektim të standardeve të sigurisë dhe një sistem dhe shpëtimi që është në dispozicion në kuadër të vetë destinacionit.

Mund të thuhet me siguri se Krusheva ofron një sërë aktivitete në natyrë, duke filluar nga aventura e lehtë, e butë deri tek aventura e vështirë. E veçanta e Krushevës është se ofron aktivitete në natyrë gjatë gjithë vitit. Për këtë analizë do të merren parasysh vetëm aktivitetet turistike aktive dhe ato aventuristike:

**Paraglajding (tandem)** - Klubet aktive dhe pilotët e certifikuar ofrojnë fluturime tandem me paraglajding nga 2 lokacione të ngritjes, që të dyja gjenden në Meçkin Kamen, ana lindore si kryesore dhe ana perëndimore si alternativë. Paraglajdingu dhe paraglajding në tandem ofrohet prej prillit deri në tetor, dhe nëse kushtet e motit në Krushevë janë të favorshme edhe gjatë sezoneve të tjera.

**Çiklizëm malor** - Komuna (Bashkia) e Krushevës, në bashkëpunim me projektin PKLR – Projekt për aftësi konkurruese lokale dhe rajonale, që financohet nga BE, ka zhvilluar mbi 40 km shtigje për biçikleta. Në bashkëpunim me sektorin privat, aktualisht janë duke zbatuar një projekt të përbashkët për zgjerimin e rrjetit të shtigjeve të shënuara për çiklizëm, duke i shtuar kilometrazhin total të shtigjeve të shënuara malore prej 80+ km.

**Skijimi** - skijim dimëror dhe sporte shoqëruese dhe rekreacion ofrohen në vendin e quajtur Staniç i cili ka dy pista për amatorë dhe një pistë profesionale e gjatë 618 metra. Ky lokacion ka një ski ashensor – me një ulëse dhe një ashensor kabllor me një ulëse. Deri te lokacioni me një teleferik (me dy ulëse), përgjatë së cilës në fakt është pista profesionale për skijim. Lartë në Staniç ka dy restorante - Scout and Shape, të cilët ofrojnë pije freskuese dhe ushqime të ndryshme. Pika e nisjes së teleferikut që çon deri në Staniç është vetëm pak minuta nga qendra e Krushevës..



**Safari dimëror** – ofrohet nga një ofrues privat i shërbimeve, ku turistët mund të shijojnë një “safari dimëror” nga maja e malit Bushava deri në vendin ku sigurohet transporti me një automjet amfib dhe prej aty turistët e shijojnë aventurën e skijimit falas, ecjes dhe aktiviteteve të tjera.

**Aventura QUAD** - mundësi për të marrë me qira një ATV me dy ulëse (automjet për të gjitha terrenet) për të eksploruar natyrën në rrethinën e Krushevës duke kaluar nëpër ndonjë nga shtigjet e shumta të mirëmbajtura ose për të dalë në rrugë të parregulluar për aventura të mvetësishme ose me një guidë.

**Parku aventuristik** - park i organizuar me disa aktivitete për adrenalinë që menaxhohet nga instruktorë të certifikuar që ofrojnë “zip linja”, ngjitje, ecje në litar dhe bouldering me çmime të përshtatshme.

**Karting Malor** - gjatë sezonit të thatë, pistat për skijim përdoren për karting malor, ku ashensori i skive i çon njerëzit deri në majë nga ku ata përdorin gravitetin për të zbritur deri në fillim të shtegut.

**Hiking dhe Trekking** -Krusheva ka potencial të madh për këtë lloj aktiviteti në natyrë gjatë gjithë vitit, duke u ofruar adhuruesve të malit shtigje të lehta, mesatare deri në të vështira. Ka guida lokale nga rrethina e Krushevës, të cilët ofrojnë turne me guidë. Shumë nga shtigjet ende janë të pa shënuara që duhet bërë në të ardhmen, por aktualisht ka më shumë se 40 km që janë të lehta për t’u ndjekur dhe për të ecur vetë.

**Kalërim**– Ky aktivitet është i standardizuar, duke filluar nga 10 deri në 30 minuta, me guidë me çmim të përshtatshëm, duke iu mundësuar vizitorëve të shijojnë peizazhet malore të Krushevës. Ka të paktën dhjetë kuaj me dy ofrues shërbimesh për këtë aktivitet turistik.

**Përvoja lokale**– edhe bërja e lokumit është një sekret që ruhet mirë. Bashkë me receta të tjera vendase mund të gatohen me banorët lokalë në shtëpitë e tyre, si ëmbëlsirat e quajtura celufki (puthje), ose çomlek, specialiteti i mishit. Këto përvoja mund të organizohen me ndihmën e ndërmjetësit të udhëtimit ose objektit lokal për akomodim.

Disa nga aktivitetet aventuristike që mund të ofrohen në Elbasan janë:

**Paraglajding** nga pllaja e Cerrujës, afër Funarit.

**Gjuajtje me Hark** mund të sigurohet në disa vende dhe destinacione në Elbasan, liqeni i Funarit, Byshek, Qerret, Gjinar, Bukanik etj.

**Kamping dhe zgarë** janë më të përshtatshmet në zonat Funar, Gjinar, Qerret, Shmil, Krrabë etj.

**Kanoë** nëpër lumin Shkumbin (në pranverë, në fillim të verës dhe në vjeshtë).

**Hiking** në shtigje të përcaktuara mirë si:

- Elbasan – Godolesh – Samurr – Labinot– Elbasan
- Elbasan – Godolesh – Funar
- Elbasan – Byshek – Shushicë – Fushë Buall – Ura e Polisit (që ndjek rrugën antike Via Egnatia)
- Elbasan – Garunje – Kalaja e Bodinit
- Elbasan – Shelcan
- Elbasan – Gjinar – Valesh (në Valesh gjenden rrënojat e një kështjelle dhe kisha të vjetër.)

**Kajak** në kanionet e lumit Gostima

**Skijim** në Gjinar dhe Funar, vetëm gjatë dimrit.

**Peshkim** në lumin Shkumbin.

**Kalërim** në Funar, Gjinar dhe Byshek

**Orientim në natyrë**, kryesisht në zonat malore në Funar, Gjinar, Shmil, Zavalinë, Bukanik, Korrë, Godolesh etj.

**Zip line** në Bukanik, Godolesh etj.

### III. 6 KOMODITETE

Siç u elaborua më sipër, komoditetit janë me interes të veçantë për zhvillimin e turizmit aventuristik pasi përfshijnë logjistikën e sigurisë, aksesin në internet, sigurimin shëndetësor dhe aksesin në objektet e ndihmës së parë, etj. Zhvillimet e fundit për shkak të COVID-19 përfshijnë lehtësira të shumta, duke përfshirë speciale masat për pastrimin e objekteve akomoduese dhe transportuese, hapësirave publike dhe vendeve me atraktive.

Krusheva dhe Elbasani kanë komoditet të moderuara që i shoqërojnë ambientet e akomodimit, transportit dhe hotelierike dhe restorantet. Përveç komoditeteve standarde për elementët mësipërm të destinacionit, Krusheva ofron ajër të pastër dhe mjedis natyror të pandotur për shkak të vendndodhjes së saj specifike dhe fruekntimit të vogël të automjeteve.

Ushqimi ka një potencial të madh tërheqës, veçanërisht për faktin që të dy territoret ende mund të ofrojnë ushqim të shëndetshëm dhe vendor, pavarësisht nëse shërbehet në restorante tradicionale ose "B&B". Qasja në internet ofrohet në çdo objekt (përveç disa akomodimeve "B&B" në pjesët rurale të Elbasanit, që është pjesë e ofertës unike që ofron paqe dhe detoksifikim onlajn.)

### IV. GJETJET KRYESORE

Analiza e të dhënave parësore të mbledhura nga intervistat e thella dhe diskutimet e përbashkëta në punëtoritë ndërkufitare, si dhe të dhënat dytësore të grumbulluara nga konsultimi i literaturës përkatëse e mundësua formimin e një pasqyre të përgjithshme të potencialeve për zhvillimin e turizmit në Krushevë dhe Elbasan. Njohuritë që përfshira në lidhje me problemet dhe mundësitë, gjendja aktuale në destinacion çojnë në përfundimin e gjetjeve kryesore, që përcillen me rekomandime përkatëse.

Në përgjithësi, si Krusheva ashtu edhe Elbasani, në bazë të analizës së mësipërme në lidhje me përkufizimin e ATTA për turizmin aventuristik si udhëtim që **përfshin të paktën dy nga tre elementët e mëposhtëm: aktivitetin fizik, mjedisin natyror dhe zhytjen kulturore**, mund të perceptohen si destinacione aventuristike dhe aktive.

Për më tepër, analiza gjithpërfshirëse e 5 elementeve kyçe të destinacionit: aksesit, akomodimit, atraksionet, aktivitetet dhe komoditetit, çojnë në konkluzionin se:

- Më së shumti ngjashmëri ka në kategoritë pikat e aksesit, atraksionet dhe komoditetet;
- Ka konsistencë të moderuar në shumëllojshmërinë e kapaciteteve akomoduese, dhe
- Ka variacione në llojin dhe cilësinë e aktiviteteve të ofruara.

Konkretisht, në Krushevë dhe Elbasan mund të arrihet lehtësisht duke i shfrytëzuar rrugët rajonale dhe lokale dhe tre aeroporte ndërkombëtare. Për më tepër, në dispozicion ka:

- Rrugë që drejtpërdrejt lidh Elbasanin dhe Krushevën dhe anasjelltas;
- Një udhëtim rreth e përfaqë me vizitë të Kosovës;
- Mbërritjet e vizitorëve të huaj duke i shfrytëzuar avio fluturimet me kosto të ulët nëpërmjet aeroporteve ndërkombëtare në Shkup, Tiranë dhe Ohër;
- Akses i mirë deri te destinacioni nëpërmjet autostradave dhe rrugëve rajonale dhe lokale si pjesë e rrugëve ballkanike.

Si Krusheva ashtu edhe Elbasani ofrojnë akomodim në Hotele, akomodim me mëngjes (B&B), bujtina dhe apartamente.

- Krusheva ofron 1250 shtretër gjatë gjithë vitit, të gjithë ndodhen në qytet;
- Elbasani ofron 998 shtretër: 810 prej tyre ndodhen në qytet dhe 188 në Gjinar dhe Funar;
- Shumica e kapaciteteve akomoduese në Krushevë dhe Elbasan janë të pranishme në platformat e rezervimit online si Airbnb dhe Booking.com;
- Stili i akomodimit në Krushevë ndryshon por në përgjithësi e ndjek mënyrën tradicionale në një përkthim modern të dizajnit arkitektonik tradicional;
- Akomodimi në Elbasan ndjek një stil bashkëkohor në shumicën e objekteve akomoduese.

Sa i përket atraksioneve, Krusheva ofron një miks unik të atraksioneve kulturore, historike dhe aventuristike në natyrë. Në të njëjtën kohë, Elbasani, aktualisht, është më i popullarizuar si destinacion për trajtime shëndetësore (Wellness), por ofron edhe aktivitete aventuristike në natyrë. Aktivitetet që tërheqin më së shumti vizitorë janë:

- Paraglajding dhe fluturime
- Ecje (Hiking)
- Çiklizëm malor
- Aktivitetet në parkun e adrenalines (zip line, etj.)
- Wellness dhe kohë të lirë
- Kamping
- Kanu dhe rafting
- Skijim
- Kalërim
- Aventurë "off road"

Konkretisht, [atrazionet kryesore të Krushevës](#) mund të përmbliidhen si më poshtë:

- Destinacionet e njohura të paraglajding dhe fluturim e njohur dhe e veçuar në hartën botërore;
- Destinacion i rëndësishëm historik për shkak të kryengritjes së Ilindenit, dhe monumenti Makedonium, që është një atraksion më vete
- Resurset kulturore
- Krusheva, si vendbanim urban me arkitekturë dhe specifike tradicionale e qytetit dhe pamje urbane (i themeluar në fund të shekullit XVII dhe fillim të shekullit XIX). Arkitekti i famshëm francez Le Corbusier ishte prekur veçanërisht nga arkitektura e Krushevës. Për krijimin e Krushevës si qytetit e rëndësishme është arrdhja e vllahëve nga Moskopoli dhe rrethinat e tij në periudhën 1769-1788;
- Të njohur janë ndërtues, zografë piktorë/ piktorë të afreskave dhe marangozë të asaj kohe;
- Kishat : "[Shën Nikolla](#)" (1832), "[Pranimi i Shën Mërisë](#)", "[Shën Gjoni Pagëzuesi](#)", "[E Diela e Shenjtë](#)", "[E Premtja e Shenjtë](#)", "[Ngjitja e Krishtit](#)", "[Trinia e Shenjtë](#)", "[Shën Vasili](#)" dhe manastiri "[Shpërfytyrimi i Shenjtë](#)" (1986);
- [Muzeu i Kryengritje së Ilindenit dhe Republikës së Krushevës](#), dhe [Muzeu i Luftës Nacional-Çlirimtare](#);
- [Shkëmborja e plumbave – muzeu në Krushevë](#), ku janë bërë plumbat gjatë Kryengritjes së Ilindenit;
- Rruga në çarshinë e vjetër me një sërë dyqanesh të vogla artizanale dhe tregtare, të renditur pranë njëri-tjetrit. Kjo është pjesa më piktoreske e qytetit, e më pas vijën mëhallat, ku zhvillohet e gjithë jeta. Nga çarshia e dikurshme e Krushevës, me famë botërore, ende janë të pranishme disa nga zanatet e vjetra: argjendaria, teneqepunuesit, këpucaria, rrobaqepësia e të tjera.
- Qendra memoriale dhe kulturore [Toshe Proeski](#) dhe [galeria Nikolla Martinoski](#), ndër të tjera;
- Një destinacion për ecje dhe çiklizëm me 40+ km shtigje të organizuara dhe të shënuara;
- Vendpushimet familjare (resortet) për pushime dimërore;
- Parku aventuristik dhe aktivitetet aventuristike në destinacion, janë në dispozicion mund të prenotohen lehtë;
- Ushqim tradicional lokal dhe autentik, gjithmonë në dispozicion në restorante.

Bashkia e Elbasanit është e pasur me atraksione turistike, gjë që lejon zhvillimin e produkteve dhe ofertave të ndryshme turistike. Edhe pse është pjesë e vijës bregdetare, ai mund të jetë interesant për lloje specifike të turistëve, duke i nxitur segmentet që i vlerësojnë se atraksionet turistike të Elbasanit janë të denja për t'u vizituar dhe rivizituar.

Më poshtë janë disa nga asetet apo pikat e forta që Elbasani mund t'i shfrytëzojë për të zhvilluar turizmin e tij më tej:

- Banjat termale të Treganit (që popullata lokale i quan Llixha). Në Tregan ka mjaft kapacitete akomoduese, ku mirëpritën mijëra turistë shëndetësorë çdo vit;



- Vende historike (Kalaja e Elbasanit, Kulla e Sahatit, Bazilika, fortesa të tjera më të vogla në zonat rurale, kompleksi termal romak Ad- Quintum, rruga romake Via Egnatia, etj.);
- Pasuritë natyrore (Rrapi i Bezistanit, Rrapi i Byshekut, lugina e Shkumbinit, etj.);
- Pasuritë kulturore (Xhamia e Mbretit, Xhamia e Nazareshtës, Kisha e Shën Mërisë, Kisha e Shën Kollit, Muzeu Etnografik, etj.);
- Ndërtesa e Auto Moto Parkut në Elbasan, një qark motorik me gjatësi rreth 5.3 km.
- Destinacione atraktive (Gjinari, Bysheku, Funari, Qerreti, Polisi etj.), të njohur për shtigjet e ecjes, festat lokale, vozitje makina të terrenit në rrugë të parregulluara (off –road), kalërim, gjuajtje me hark, rafting;
- Kuzhina tradicionale, mënyrë e veçantë e gatimit të ushqimit dhe specialiteteve lokale, traditë e gjatë e mikpritjes;
- Festa e njohur në nivel kombëtar, “Dita e Verës” dhe festivale të tjera rajonale ose rurale;
- Llojet e ndryshme të relievave që mundësojnë një spektër të gjerë sportesh dhe aktiviteteve në natyrë.
- Mbështetje nga profesorët dhe studentët e Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”; dhe hapja e studimeve për Turizëm;
- Angazhimi i pushtetit lokal për dizajnimin dhe realizimin e strategjisë për zhvillimin e turizmit (Bashkia Elbasan);
- Projektet e OJQ-ve për zhvillimin e turizmit;
- Shoqata specifike sportive, si “Shoqata e Alpinizmit, Skijimit dhe Turizmit Malor”, me zyrë në Elbasan;
- Operatorë turistikë të përkushtuar, si “Albanian Sport Tourism” dhe “Elite Travel”.

Sa i përket komoditeteve, si Krusheva ashtu edhe Elbasani ofrojnë mbulim standard dhe të rregullt të aksesit në internet dhe institucione të mbrojtjes shëndetësore në nivele të kënaqshme. Mungon transporti i organizuar lokal.

Hulumtimi i realizuar ka kontribuar në identifikimin e disa problemeve dhe sfidave për zhvillimin e mëtejshëm të turizmit në Krushevë dhe Elbasan:

- Mungesa e një dokumenti të veçantë – strategji për zhvillimin e turizmit në Bashkinë Elbasan. Megjithatë, një mendim pozitiv ndaj turizmit mbizotëron në aktivitetet e përditshme të Bashkisë Elbasan dhe organeve të tjera të qeverisjes lokale. Hartimi i një strategjie të qartë dhe të shkruar për zhvillimin e turizmit është thelbësore;
- Nuk ka sistem me një sportel (one-stop-shop) - Qendër Informativ Turistike në Krushevë - që ofron informacione të sistemuara dhe promovuese për ofertat turistike në qytet;
- Nuk ka një ofertë turistike të sistemuar dhe të integruar në formën e produkteve të gatshme për përdorim, si p.sh. turne me guidë deri te atraksionet në Krushevë dhe Elbasan;
- Nuk ka mesazh të qëndrueshëm dhe unik promovues për brendin Krushevë nëpër kanalet reklamuese;
- Nevojitet edhe promovim më i madh në nivel kombëtar, tek vizitorët vendas, të atraksioneve në Krushevë, veçanërisht të aktiviteteve aventuristike në natyrë;
- Ka mungesë të madhe të guidave vendase të certifikuara, të cilët zotërojnë mirë disa gjuhë të huaja, përfshirë edhe anglishten;
- Në Elbasan mungojnë guida malorë që flasin mirë anglishten;
- Menaxhimi i mbetjeve kërkon përmirësime, veçanërisht në vendet që janë atraktive për turistët në Krushevë, zonën e Funarit dhe në Elbasan;
- Në Krushevë nevojiten përmirësime të caktuara infrastrukturore për të mbështetur ofertën aventuristike: rindërtimi i rrugës deri në pistën për fluturim për praglsjding dhe në Meçkin Kamen, ndërtimi i një “zip line” më të gjatë dhe me kapacitet më të madh;
- Nevojitet ndërtimi i kapaciteteve dhe përmirësimi i performancës së ofruesve të shërbimeve hotelierike, në mënyrë që të përmbushen pritshmëritë e turistëve.
- Nevojitet një rrjetëzim i mëtejshëm, veçanërisht me organizata të caktuara ndërkombëtare aventuristike, për të shkëmbyer përvoja dhe “know-how”;
- Nevojitet modernizim i kurrikulës në arsimin e mesëm në hotelieri dhe përmirësimi i bashkëpunimit me sektorin privat;

- Nuk ka asnjë aplikacion online digjiital të përgatitur për turne të vetë-drejtuar (për çiklistë dhe bjeshkatarë) në shumë gjuhë;
- Në Bashkinë e Elbasanit nuk ka një Drejtor të dedikuar për politika dhe zhvillimin e turizmit. Përgjegjësitë për turizmin ndahen ndërmjet dy drejtorive ekzistuese, gjë që mund të çojë në mosharmonizim në koordinimin e politikave dhe aktiviteteve.
- Infrastruktura e dobët rrugore drejt pikave kryesore turistike me interes si Funari, Gjinari, Qereti apo Polisi. Rruga deri në Funar është në gjendje të keqe, ndonëse kohët e fundit kjo zonë është promovuar intensivisht si destinacion turistik lokal. Është planifikuar ndërtimi i rrugës për në Funar dhe lidhja e saj me autostradën Tiranë-Elbasan, do ta bëjë atë lehtësisht të aksesueshme dhe do të shkurtojë kohën e udhëtimit deri në destinacion. Megjithatë, ky projekt është ende në fazën e fizibilitetit, që do të thotë se do të duhen disa vite për të përfunduar.
- Asnjë ueb faqe e specializuar nuk e promovon Elbasanin, atraksionet dhe aktivitetet e tij turistike, si dhe ngjarjet që ndërlidhen me turizmin. Nuk ka asnjë faqe të dedikuar në mediat sociale. Në një kohë kur shumica e turistëve përdorin median online si burimin kryesor të informacionit, ky është një disavantazh serioz për Elbasanin. Shumica e informacioneve për Elbasanin vijnë nga media kombëtare, faqet e administruara privatisht ose faqet ndërkombëtare. Pjesa më e madhe e informacioneve, veçanërisht nga burime private, janë të vjetruara.
- Janë shënuar një numër i parëndësishëm i rrugëve turistike. Në Bashkinë e Elbasanit nuk ka katalog të shtigjeve të shënuara për ecje, bjeshkatarë apo çiklizëm. Peizazhi i larmishëm, relievet kodrinore dhe malore ofrojnë shumë shtigje interesante dhe emocionuese me nivele të ndryshme vështirësie. Informacionet e këtyra nuk janë gjerësisht në dispozicion, ndërsa shtigjet dhe rrugët turistike janë të njohura vetëm për disa alpinistë ose entuziastë me përvojë.
- Nuk ka bashkëpunim të formalizuar dhe institucional ndërmjet aktorëve të turizmit në Elbasan. Herë pas here organizohen punëtori, takime apo konferenca për turizmin, por takime formale dhe periodike ndërmjet palëve të interesuara për zhvillimin e turizmit, nuk ka
- Mungon një listë ose hartë e plotë e atraksioneve turistike në Bashkinë Elbasan. Në ueb faqet ka informacione për atraksione dhe destinacione të ndryshme në Elbasan, por nuk ka një listë të kategorizuar me të gjitha informacionet dhe të dhënat përkatëse. Kjo listë do të plotësohej me informacione të dobishme dhe të përditësuara për akomodimin, ushqimin dhe argëtimin në Elbasan.
- Në Elbasan nuk ka një zyrë formale informacioni për turizmin. Megjithëse shumica e vizitorëve mbështeten në burime online, ngritja e një pike informative për atraksionet turistike në Elbasan do të tregonte një angazhim serioz ndaj turizmit dhe turistëve.

## V. REKOMANDIME

Në bazë të analizës së mësipërme të të dy destinacioneve lokale dhe hulumtimit të mundësive për zhvillimin e paketave të përbashkëta turistike aventuristike, mund të konkludohet se edhe Krusheva edhe Elbasani duhet të ndjekin zhvillimin e mëtejshëm të turizmit në udhëtimet aventuristike, pasi potenciali i tyre më i madh është në atë lloj specifik të turizmit.

Në këtë drejtim, të dy destinacionet ndajnë elemente të cilat janë bazë për lidhjen e ofertë, duke pasur parasysh situatën aktuale dhe e përdorin atë si bazë për zhvillim të mëtejshëm, duke i ndjekur rekomandimet e mëposhtme:

- Themelimi i një organizate për menaxhimin e destinacionit - DMO për Krushevën (komuna);
- Zhvillimi i propozimit unik për shitje USP dhe propozimit unik për vlerë (UVP) për Krushevën (DMO)
- Zhvillimi i mesazheve promovuese të qëndrueshme dhe unike për aventurë gjatë gjithë vitit në Krushevë (DMO)
- Zhvillimi dhe zbatimi i një fushate kombëtare reklamimi për Krushevën (përpyetje e përbashkët e të gjitha palëve të interesuara)
- Zhvillimi i turneve aventuristike gjysmëditore të standardizuara dhe kulturore si ofertë e rregullt në Krushevë (DMO)
- Anëtarësimi në shoqatat ndërkombëtare të udhëtimeve aventuristike për rrjetëzim të mëtejshme, siç është ATTA (komuna)
- Ngritja e skemës së subvencionimit/granteve për certifikimin e guidave lokale në bjeshkatarë dhe çiklizëm (komuna)

- Organizimi i trajnimeve për ngritjen e kapaciteteve për stafin në hotelieri (bashkëorganizim me donatorë ndërkombëtarë; sektori civil etj)
- Aplikimi i transportit turistik lokal falas (minibus i hapur hop-on-hop-off)
- Futja në përdorim dhe implementimi i një sistemi lokal për qëndrueshmërinë dhe destinacionin e gjelbër në Krushevë (DMO)
- Futja në përdorim dhe përmirësim i infrastrukturës për destinacionin e çiklizmit në Krushevë (shtigje për çiklizëm kapacitete akomoduese)
- Zhvillimi dhe promovimi i mjeteve dixhitale (të bazuara në ueb aplikacione) për shëtitje dhe xhiro me biçikletë të vetë-drejtuar në Krushevë
- Shënim i mëtejshëm i shtigjeve për ecje dhe çiklizëm në Krushevë, sidomos në terrenet e skijimit gjatë verës (koncesioner privat, komuna);
- Prezantimi i shtigjeve të biçikletës në zbritje gjatë verës në pistat e skive (koncesioner privat, bashki)
- Përmirësimi i mëtejshëm i infrastrukturës për paragjajding, vendi shtesë për fluturim dhe rrite të kapacitetit të lokacionit
- Përmirësimi i mëtejshëm e rrjetit rrugor, fokusimi në aksesin rrugor deri te atraksionet: Meçkin Kamen (Shkëmbi i Ariut) dhe Parku Aventuristik
- Ndërtimi i zip linjës së gjatë dhe me kapacitet më të madh në Krushevë
- Futja në përdorim e një sistemi për siguri dhe shpëtim në Krushevë (komuna, klubet sportive dhe të paragjajdingut)
- Bashkëngjitje në nisma të mëtejshme për ofertë të integruar aventuristike ndërkufitare
- Ofrimi i Krushevës si pjesë e udhëtimeve ballkanike rreth e përçark (prezenca në panairët turistike, komuna)
- Pastrimi i qytetit të Krushevës, përmirësimi i menaxhimit të mbeturinave (komuna, ndërmarrjet komunale)
- Prezantimi i të paktën dy ngjarjeve të mëdha në Krushevë, mundësisht një në vjeshtë dhe një në pranverë
- Bashkia e Elbasanit duhet të hartojë një strategji bazë për zhvillimin e turizmit në Elbasan. Në hartimin e strategjis duhet të përfshihen të gjithë aktorët e interesuar si dhe resurset e kualifikuara njerëzore në nivel lokal dhe kombëtar. Lloji i njëjtë i pjesëmarrësve që ishin të pranishëm në dy punëtoritë e organizuara gjatë këtij projekti (KET) janë më se të përshtatshëm për diskutim dhe zhvillim të strategjisë turistike në nivel.
- Zhvillimi i një identiteti turistik për Elbasanin, gjegjësisht atë çfarë përfaqëson Elbasani. Një logo dhe shenjë specifike duhet të shoqërojë brendimin e Elbasanit. Kjo do ta bënte Elbasanin më të dallueshëm dhe do ta lidhte lehtësisht emrin e tij me atraksionet specifike që i ofron për turistët. Logoja dhe slogani do të përdoren në çdo aktivitet të lidhur me turizmin.
- Revitalizimi i atraksionit më të vlefshëm të Bashkisë, Kalanë e Elbasanit. Është një vend i përsosur për ta kthyer atë në "një qytet të vjetër", me dyqane suveniresh, punëtori tradicionale, restorante etnike, kafene, muzikë live dhe shfaqje dhe aktivitete të tjera kulturore si ekspozita. Sheshi përballë portës jugore të kalasë të jetë zonë vetëm për këmbësorë, duke krijuar një lidhje atraktive me bazilikën, Rrapin e Bezistanit (Platanus), Muzeu Etnografik dhe Xhamia e re Balli.
- Krijimi i një Drejtorie të veçantë për turizëm, politika dhe zhvillim në Bashkinë Elbasan. Kjo do të rezultojë në një fokus të përmirësuar, ndërlihdje dhe koordinim më të mirë të aktiviteteve.
- Zhvillimi i një ueb faqeje të dedikuar për turizmin në Elbasan, si dhe faqeve përkatëse në rrjetet sociale. Ato faqe do të përmbajnë informacione përkatëse për turizmin dhe destinacionet në Elbasan, duke i përditësuar ato çdo ditë. Ueb-faqja është një mjet i shkëlqyer dhe me kosto të ulët për të promovuar Elbasanin në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar;
- Etablimi, shënjimi, përveç ecjes dhe çiklizmit, këto aktivitete në natyrë mund të prezantohen në mënyrë të organizuar në destinacionin Elbasan - Krushevë:
- Gjuajtje me hark: ushtrime për përfitim të shkathtësive për përdorim të harkut dhe për të gjuajtur.
- Vozitje me ATV: vozitje me automjete të terrenit për qëllime rekreative.



- Kampingu: aktivitet në natyrë që përfshin fjetje larg shtëpisë, qoftë pa strehë ose duke përdorur strehëza bazë si çadra ose automjete rekreative.
- Backpacking: bartja e pajisjeve në shpinë gjatë ecjes për më shumë se një ditë. Shpesh është një udhëtim i zgjatur dhe mund të përfshijë kamping në natyrë.
- Vëzhgimi i shpendëve/teleskop: vëzhgimi i zogjve si një aktivitet rekreativ ose një formë e shkencës qytetare. Vëzhguesi i shpendëve mund të shikojë duke përdorur syrin e tij, duke përdorur ndonjë pajisje shtesë për përmirësim vizual si dylbi ose një teleskop dhe duke dëgjuar këndimin e shpendëve.
- Kanu: aktivitet që përfshin kanotazh me një lopatë
- Lundrim me kanu në ujëra të shpejtë dhe me dërrasa për surfim
- Disk golf: një sport me disk fluturues ku lojtarët e hedhin një disk drejt një caku; luhet me rregulla të ngjashme me golfin;
- Shtegu i fitnesit: përbëhet nga një shteg me pajisje për ushtrime në natyrë ose pengesa të instaluar përgjatë shtegut për ushtrime trupore për promovim të shëndet të mirë.
- Peshkimi në lumë, kalërim dhe zgarë
- Fluturim me lëvizje: sport ajror ose një aktivitet rekreativ në të cilin një pilot fluturon me një aeroplan të lehtë, pa motor që është më i rëndë se ajri, i cili lansohet me këmbë.
- Gjueti, bjeshkatari, alpinizëm dhe vozitje jashtë rrugës (off-road)
- Orientimi: një aktivitet që kërkon aftësi për navigacion përdorur një hartë dhe busull për të kaluar nga një pikë në tjetrën në terrene të ndryshme dhe zakonisht të panjohura ndërsa lëvizni me shpejtësi. Pjesëmarrësve u jepet një hartë topografike, zakonisht hartë orientuese e përgatitur posaçërisht, të cilën ata e përdorin për të gjetur pikat e kontrollit.
- Fitnes në natyrë: përbëhet nga ushtrime që realizohen jashtë palestrës sportive për të përmirësuar kondicionin fizik.
- Palestër në natyrë: Me vegla për ushtrime me pesha e ndërtuar jashtë në natyrë;
- "Airsoft/paintball": një lojë ekipore në të cilën pjesëmarrësit i eliminojnë lojtarët kundërshtarë duke i goditur me predha plastike sferike të shkrepura me pistoleta ajrore të rreme;
- Fotografim;
- Largim: Zbritje e kontrolluar në shpat të pjerrët, si p.sh. ndonjë shkëmb, duke lëvizur teposhtë nëpër një litar;
- Plogging: Kombinim i vrapimit dhe mbledhjes së mbeturinave. Si një stërvitje, ofron variacion në lëvizjet e trupit duke shtuar përkuljen, mbledhjen dhe zgjatjen në veprimin kryesor të vrapimit, ngjitjes në mal ose ecjes;
- Ngjitje në pemë, Vrapim;
- Rafting: një aktivitet rekreativ ku përdoret një gomone e fryrë për të lundruar në lumë ose një trup tjetër të ujit;
- Linja ZIP: Një makare (çekërk) e varur nga një kablo, zakonisht prej çeliku inox, e montuar në një pjerrësi. Është projektuar për të lejuar personit që shtyhet nga gravitacioni të udhëtojë nga maja deri në fund të një kabllorje të pjerrët, duke u mbajtur ose duke u shtrënguar në një makare që është në lëvizje të lirë.
- Vendosja e bashkëpunimit formal ndërmjet palëve të interesuara në turizmin nga Elbasani dhe Krusheva. Mund të organizohen takime periodike në të cilat do të analizohen dhe diskutohen zhvillimet më të fundit në turizëm, si dhe sfidat dhe planet e ardhshme. Nuk ka mënyrë më të mirë sesa bisedat ballë për ballë për gjithçka që prek të gjithë palët e interesuara. Organizimi i takimeve të tilla do të kontribuojë në harmonizimin e përpjekjeve dhe arritjen e sinergjisë në promovimin dhe zhvillimin e turizmit në Elbasan dhe Krushevë.
- Përpilimi i një liste të plotë dhe të përditësuar të gjitha atraksionet turistike në Elbasan. Kjo listë më pas mund të kombinohet me informacione të tjera për të krijuar oferta dhe produkte specifike udhëtimi

për lloje të ndryshme turistësh (siç u diskutua më parë). Kjo do të rrisë atraktivitetin e Elbasanit si destinacion turistik.

- Sipas standardeve më të fundit ndërkombëtare, ka nevojë për të hapur një zyrë për shkëmbim të informacioneve për turistët. Kjo zyrë do të shërbente si pikë referimi për turistët e huaj apo vendas. Gjithashtu, përveç informacionit ballë për ballë për vizitorët, qendra e informacionit turistik mund të organizohet si një dyqan suveniresh dhe për ndarjen e materialeve të printuara promovuese.
- Hulumtimi dhe promovimi i katakombeve në Elbasan, të cilat janë ende të panjohura për shumicën e banorëve të Elbasanit. Këto katakombe shtrihen nën qytet dhe shumica ende nuk janë të eksploruara. Ato nisin nga kalaja në qendër të Elbasanit dhe shtrihen në drejtim të periferisë së qytetit.
- Modifikimi dhe përshtatja e kurrikulave aktuale të programit universitar në turizëm që ofrohet nga Universiteti i Elbasanit, për përshtatje më të mirë me nevojat dhe kërkesat e sektorit të turizmit. Kjo do të thotë bashkëpunim më i mirë mes bizneseve turistike dhe departamenteve përkatëse të Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani". Disa nga temat që mund të ofrohen janë "Dizajnimi për përvojën e vizitorëve", "E ardhmja e turizmit", "Menaxhimi i atraksionet turistike", "Turizmi i veçantë", etj. Gjithashtu, mund të organizohen seminare të hapura ku përfaqësues nga bizneset e turizmit të Elbasanit mund të ndajnë ekspertizën dhe përvojat e tyre me studentët dhe pedagogët e Universitetit të Elbasanit.
- Zhvillimi i një oferte trajnimi konkret për individë dhe punonjës të interesuar për të avancuar në sektorin e turizmit. Ky trajnim duhet të jetë i orientuar drejt praktikës dhe mund të zhvillohet nga ekspertë/praktikantë të turizmit dhe profesorë të turizmit. Të gjithë duhet të përfitojnë nga përvojat dhe njohuritë e përbashkëta për t'u rritur profesionalisht dhe për të avancuar në karrierën e tyre.

## VI. Drejtimet strategjike për promovimin e paketës turistike Krushevë-Elbasan

**Marketingu i destinacionit** është një aktivitet kompleks dhe i ndërlidhur që i bashkon të gjithë aktorët relevantë në nivel lokal dhe kombëtar rreth një qëllimi të përbashkët. Qëllimi është të rritet ndërgjegjësimi i klientëve për një destinacion të caktuar, që ata të fillojnë të mendojnë për vizitë ose t'i ndihmojnë ata të kujtojnë lokacionin për momentin kur do të planifikojnë udhëtimet ose pushimet e tyre. Me përcaktimin dhe zhvillimin e faktorëve kryesorë të atraktivitetit të destinacionit e përgjithshëm si një brendi unike, klientët potencialë do të vendosin të prenotojnë udhëtimin deri te ai destinacion për shkak të promovimit të tij.

Marketingu i destinacionit është një aktivitet kyç i Organizatës për Menaxhim të Destinacionit (DMO), siç u përmend më parë në rekomandimet, pjesa V e kësaj analize. Marketingu si një mjet i aplikuar përdoret për të sjellë më shumë vizitorë në zonë, për të nxitur ekonominë lokale dhe për të vendosur veten si një destinacion i dëshirueshëm udhëtimi dhe vizite.

Qëllimi kryesor i marketingut të destinacionit është të **ndërgjegjësojë dhe të interesojë klientin për destinacionin** përpara se të mbërrijë. Thexsimi i lokacionit do të thotë që DMO ose subjekti që e zbaton strategjinë e marketingut duhet të gjejë një mënyrë për të promovuar dy zona - një udhëtim, siç është rasti me ofertën e përbashkët aktive turistike Krushevë-Elbasan. Pavarësisht ofertave të vazhdueshme në drejtim të udhëtimeve aventuristike dhe aktive, produkti turistik po zgjerohet përtej kufirit, duke përfshirë dy territore ndërkufitare.

**Brendimi i një destinacioni turistik** kërkon një strategji afatgjatë të integruar në kanale të shumta dhe shkon përtej fushëveprimit të këtij dokumenti. Sidoqoftë, brendimi i destinacionit është më shumë se thjesht vetëm logo, sinjalistikë, reklama, bilborde dhe postime në mediat sociale.

Perceptimi i vizitorëve përcakton brendin e destinacionit. Është një emocion që vizitorët e ndiejnë, që e shkaktojnë përvojat e krijuara nga aktorët e interesuar të turizmit, që do të thotë se hulumtimi i qëndrueshëm dhe afatgjatë i kënaqësisë së vizitorëve duhet të përdoret, nga DMO-të lokale, në mënyrë sistematike dhe të organizuar, në mënyrën më të përshtatshme për të marrë dhe organizuar të dhëna përkatëse. Zbatimi i suksesshëm i një strategjie të brendimit duhet të fillojë duke parashtruar pyetjen: "Çfarë e bën destinacionin tonë unik dhe çfarë i tërheq vizitorët?", e pas kësaj të ketë analizë dhe interpretim të të dhënave të mbledhura nga destinacionet lokale në prioritet, masa dhe veprime konkrete drejt një strategjie të marketingut të atij destinacioni. Kështu, çdo hap duhet t'i caktohet një ose më shumë aktorëve të interesuar që do jenë përgjegjës për zbatimin, së bashku me një afat kohor dhe buxhet.



Tendencat e marketingut për një destinacion tregojnë se komunikimi online me turistët e mundshëm i nxit lëvizjet turistike në nivel global. Konkretisht, sipas Raportit të Trendeve të Udhëtimit 2018, **9 nga 10 udhëtarë vlerësojnë se është e domosdoshme të lexohen komente dhe vlerësime e vendosura në internet.** Përveç kësaj, 95% e udhëtarëve u besojnë gjithmonë komenteve për turne, udhëtime dhe aktivitete në faqet e palëve të treta si TripAdvisor.

Megjithatë, **le të supozojmë se destinacioni nuk është ende aq i popullarizuar.** Në atë rast, ata që shpenzojnë për udhëtime (vizitorët e ardhshëm) kërkojnë fotografi dhe video materiale për të mësuar se çfarë të presin nga lokacioni që dëshirojnë të vizitojnë. Megjithatë, hapi i parë në promovimin e destinacionit është të theksohet një territori i caktuar ose të tërhiqet vëmendja për atraksionet dhe përvojat specifike për vizitorët. Në Figurën e mëposhtme janë paraqitur faktorët që duhet elaboruar në mesazhin që u komunikohet vizitorëve potencialë që ndikojnë në aftësinë konkurruese të tij, që do të thotë se vizitorët duhet të zgjedhin destinacionin tonë në krahasim me ata që ofrojnë produkte të ngjashme turistike.

**Tabela 8: faktorët që ndikojnë në aftësinë konkurruese**

ÇFARË NDIKON NË AFTËSINË KONKURRUESE	
Atraksione	Resurset natyrore, kulturore, artificiale, ngjarje
Mundësia e aksesit	Infrastruktura rrugore, hekurudhore, aeroportet
Rekreacion	Aktivitete komerciale, shërbime të tjera etj.
Akomodimi	Shërbimet e akomodimit (hotele, "B&B", shtëpi, akomodim lokal)
Aktivitetet	Të gjitha aktivitetet: aventuristike, sportet, kulturore etj.
Mundësia e aksesit komercial	Paketa dhe oferta të disponueshme në treg

Faktorët e lartpërmendur për Krushevën dhe Elbasanin janë elaboruar gjerësisht në seksionet e mëparshme (II.1 deri III.6). Gjithashtu, u hulumtuan dhe u elaboruan ngjashmëritë e tyre. Në bazë gjetjeve, duhet të zhvillohet një USP si bazë për krijimin e një strategjie specifike Marketingu për destinacionin aktiv Krushevë - Elbasan.

### Propozim unik për shitje - USP (indikativ)

Siç u elaborua më parë, destinacioni Krushevë-Elbasan përballet me destinacione lokale konkurruese në zonën ndërkufitare që ofrojnë produkte të ngjashme turistike për të njëjtin qëllim (turistët) në segmente të ndryshme të tregut dhe me çmime të barabarta ose më të ulëta. Atraksionet në destinacionet konkurruese janë identike. Pjekuria e destinacioneve (shkalla e zhvillimit dhe e njohjes si destinacion turistik) është më e lartë se ajo e Krushevë-Elbasanit, e parë si një destinacion i përbashkët për temën e aventurës.

Megjithatë, paketa e përbashkët turistike e destinacionit Krushevë-Elbasan se perceptohet si **"një udhëtim - dy shtete"**. Nga ana tjetër, ndjeshmëria ndaj çmimeve të segmenteve të tregut që synojnë individë aventurierë dhe grupe të vogla apo private është e lartë, sepse ata priren të udhëtojnë me një buxhet të caktuar që duhet të merret parasysh kur promovohet destinacioni Krushevë-Elbasan në një paketë udhëtimi aventuristik.

Një propozim konciz, unik i shitjes bazohet në veçoritë gjeografike dhe atraksionet që e bëjnë destinacionin më konkurrues se konkurrenca, duke marrë parasysh asetet më të njohura dhe faktorët e atraktivitetit. Më poshtë është paraqitur një ushtrim për zhvillimin e USP, i realizuar gjatë përgatitjes së këtij dokumenti. Rekomandohet që për të siguruar pronësinë lokale të USP-së, duhet të zbatohet një proces me pjesëmarrje më të madhe dhe përfshirje të më shumë aktorëve kombëtarë dhe lokalë. Në këtë drejtim, indikative janë sugjerimet e mëposhtme për USP:

**Tabela 9: propozimi unik i shitjes i destinacionit Krushevë - Elbasan**

<b>Propozim unik për shitje të destinacionit Krushevë - Elbasan</b>	
Çfarë e bën unik Krushevë-Elbasan?	Dy vende - një udhëtim;
Cili është thelbi i destinacionit?	Aventurë, aktivitete në natyrë;
Çfarë i motivon udhëtarët ta zgjedhin destinacionin?	Ushqim i shijshëm, njerëz mikpritës, qetësia dhe relaksim në natyrë, aktivitete fizike si ecje dhe çiklizëm, peizazhe spektakolare, ndërveprim me popullatën lokale;
Cili është mendimi i turistit për destinacionin?	E pazbuluar, private, e gjelbër dhe mikpritëse.
<p><b>Një destinacion gjatë gjithë vitit për aventura familjare!</b>  <b>Natyrë, aventurë dhe ushqim i shijshëm për një detoksikim urban!</b>  <b>Përjetoni shtigjet e lashta dhe ndjehuni si romak!</b>  <b>Përshtateni trupin tuaj duke iu përshtatur natyrës!</b></p>	

### Segmentimi i tregut

Meqenëse destinacioni Krushevë-Elbasan është ende në fazën fillestare të prezantimit të përbashkët të ofertës së tij turistike dhe ka një prani shumë të kufizuar në tregjet e huaja, analiza e mëposhtme ka të bëjë me segmentimin dhe pozicionimin e tregut, pasi këto gjetje janë parakushte për optimizimin e strategjisë së marketingut. .

Sipas pajtimit të përgjithshëm, nuk diskutohet për shijet e ndryshme të njerëzve. Nga kjo rrjedh se çdo turist duhet të vëzhgohet individualisht. Ata të gjithë tërhiqen nga një destinacion i caktuar për arsye dhe shije të ndryshme, duke filluar nga një pushim pa brenga deri në një kënaqësi shumë specifike.

Një njohje tjetër është se industria turistike në asnjë rast nuk mund t’u shërbejë të gjithë udhëtarëve individualisht, që sjelle deri te segmentimi i tregut. Për më tepër, segmentimi i tregut turistik mund të përdoret nga të gjitha aktorët e interesuar, nga restorantet dhe hotelet e deri tek operatorët turistikë dhe destinacionet ndërkombëtare të vogla apo të mëdha, siç është elaboruar në këtë Analizë.


Në këtë pjesë elaborohen karakteristikat gjeografike, demografike dhe psikografike (mënyra e jetesës) e vizitorëve, të cilët vijnë në destinacionin Krushevë – Elbasan vetëm lidhur me OFERTËN E PËRBASHKËT AVENTURISTIKE. Analiza e segmentimit të tregut më poshtë i referohet vetëm produkteve të përbashkëta turistike, të zhvilluara në kuadër të portofolit aventuristik të të dy destinacioneve lokale, që përfshijn paketa unike turistike.

Tregu i jashtëm duhet të shihet si një grup nën-tregjesh të ndryshëm të formuar në bazë të karakteristikave të tjera personale të çdo klienti, me çka do t’iu mundësohet destinacioneve të veçohen në plotësimin e nevojave të një grupi ose segmenti të caktuar të tregut. Gjatë përzgjedhjes së turistëve të huaj, destinacionet duhet të përcaktojnë nëse do të zgjedhin tregun në bazë të kufijve të shtetit apo do të eksplorojnë segmente të ndryshme të tregut që adresojnë nevojat e përbashkëta të udhëtarëve (vizitorëve) në nivel ndërkombëtar.

Duke mos i ndjekur vetëm të dhënat për ardhjet e vitit 2022 për Krushevën pasi këto paraqesin rrethana të jashtëzakonshme dhe nuk mund të përdoren si tregues për vendosjen e synimeve në të ardhmen, aktorët e interesuar lokalë raportojnë për ardhje sipas kategorisë dhe jo sipas vendndodhjes gjeografike. Krahas mërgimtarëve – qytetarëve që jetojnë jashtë vendit dhe kryesisht kthehen gjatë verës për të vizituar miqtë dhe të afërmit ose për një vizitë njëditore, në figurën 5 janë paraqitur edhe bujtjet e vizitorëve për periudhën e gjashtë muajve të parë të vitit 2022, sipas shteteve të origjinës në Krushevë .



**Figura 5: Numri i bujtjeve të turistëve, sipas vendit të origjinës, në Krushevë**



Burimi: Baza e të dhënave Makstat, 2022

Të dhënat e paraqitura në grafikun e mëparshëm për ardhjet e turistëve sipas vendeve të origjinës i mbështesin dëshmitë nga hulumtimi në terren nga Krusheva se turistët vijnë nga vende të ndryshme me atë që tendenca e ardhjeve më të mëdha janë nga rajoni, pra më së shumti vizitorë në gjashtëmuorin e parë të vitit 2022. janë nga Sllovenia dhe Shqipëria, e më pas nga Turqia. Meqenëse fushëveprimi i këtij segmentimi tashmë është ngushtuar gjeografikisht në tregun e udhëtimeve jashtë vendit në vendet evropiane dhe vendet fqinje të Maqedonisë së Veriut dhe Shqipërisë, **përpjekjet duhet të përqendrohen në identifikimin e grupeve të ndryshme të turistëve individualë**, subjekteve ndërmjetësuese si operatorët turistikë, agjencitë turistike - kompani tradicionale ose online.

Bazuar në elaborimin e mëparshëm për mundësinë e aksesit deri te destinacioni, një nga çështjet kyçe për të përcaktuar nëse një destinacion do të tërheqë turistë dhe vizitorë të huaj është mundësia e fluturimeve direkte për dhe nga aeroportet ndërkombëtare në Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërisë.

Hulumtimi i realizuar për udhëtimet për në Maqedoninë e Veriut dhe për në Shqipëri tregoi se turistët evropianë preferojnë lidhje të drejtpërdrejta me destinacionin përfundimtar, në vend të fluturimeve me ndalesa të shumta. Për më tepër, disa operatorë me kosto të ulët ofrojnë fluturime të lira direkte për dhe nga të dy vendet (WIZZ AIR, Germanwings, Blueexpress, etj.).

Segmentimi i tregut bazuar në kategoritë dhe jo në klasterët gjeografikë mundëson targetimin e turistëve të mundshëm duke përdorur analizën e faktorëve. Analiza e faktorëve të stilit të jetesës së vizitorëve nga vitet e mëparshme duhet të merret se ka ndikim të kufizuar, pasi dëshmitë nga terreni kufizohen në raportet e aktorëve të interesuar lokalë, gjegjësisht të dhëna anekdotike. Gjithashtu, analiza e faktorëve, për të marrë dëshmi të faktorëve të stilit të jetesës së vizitorëve kombëtarë që vijnë në Krushevë për një udhëtim ditor ose pushime, përfshin të dhëna nga viti 2022.

Duke hyrë në detaje më tej, **tregjet e burimeve kryesore dhe segmentet e konsumatorëve** të pranishëm në destinacionin Krushevë, të gjitha kategoritë, pavarësisht nga vendi i origjinës, janë analizuar më tej me ndihmën e analizës së faktorëve. Pesë lloje të vizitorëve u identifikuan bazuar në preferencat e tyre të stilit të jetesës: **kërkuesit e aventurave (kryesisht paraglajding), adhuruesit e natyrës, eksploruesit e kulturës, vizitorët aktivë të sporteve dhe familjet që udhëtojnë për pushime dhe relaksim.**

Faktorët e stilit të jetesës nuk janë vendimtarë për preferencat turistike, sepse faktorët e jashtëm gjithashtu ndikojnë shumë në sjelljen e turistëve dhe vendimin e tyre përfundimtar për të vizituar një destinacion. Analiza e mëtejshme e bazuar në moshën, gjininë dhe statusin familjar ka zbuluar se turistët që mbërrijnë në destinacionin Krushevë janë kryesisht të moshës së mesme, kryesisht në marrëdhënie familjare ose

të rinj që shoqërohen dhe udhëtojnë në grup. Një grup tjetër janë vizitorët më të vjetër të cilët janë të organizuar në grupe kulturore turistike.

Pas segmentimit të tregut bazuar në analizën gjeografike, demografike dhe psikografike (të stilit të jetesës), destinacioni Krushevë duhet të synojë vizitorët e mundshëm nga segmentet e mëposhtme të tregut:

- Familje me të ardhura mesatare që e duan natyrën, aventurat e buta dhe shijimin e gjërave lokale;
- Të rinjtë që udhëtojnë për të zbuluar destinacione aktive pushimi;
- Sportistët/atletët profesionistë për përgatitjet para sezonit garues;
- Të moshuarit që udhëtojnë të organizuar nga një ndërmjetës (agjenci udhëtimi) për eksplorimin kulturor të destinacioneve "të reja";
- Për qëllime biznesi për aktivitete të lidhura me biznesin, të tilla si aktivitetet e ndërtimit të ekipit, takime, konferenca, seminare, panaire dhe trajnimet; dhe
- Udhëtarë individualë, të cilët kërkojnë aventura në destinacione turistike më pak të njohura.

Sipas intervistave të thelluara dhe punëtoritë e realizuara për profilizimin e tregut turistik dhe një destinacion të mundshëm tematik të përbashkët me Elbasanin, u identifikuan llojet e mëposhtme të turistëve:

- Qëllime biznesi: këta persona e vizitojnë Elbasanin për aktivitete biznesi, si marrëveshje biznesi dhe takime, konferenca, punëtori, panaire dhe trajnime.
- Qëllimet personale (shëndeti): këta persona vizitojnë destinacione të caktuara në Elbasan, si banjat termale Tregan (Llixha) apo Gjinar.
- Historike/Kulturore/Aventuristike: Këta individë e vizitojnë Elbasanin për resurset e tij të ndryshme historike, kulturore dhe natyrore. Kjo kategori përfshin edhe vizitorë në ditë të ndryshme tradicionale apo aktivitete të lidhura me sportin.
- Vizita familjare: festime apo tubime familjare, dasma, funerale etj.
- Pasagjerë transit: Individë që udhëtojnë drejt destinacioneve të tjera dhe pushojnë në Elbasan.

Këta turistë dhe vizitorë kanë nevojë për një spektër të gjerë produktesh dhe shërbimesh. Disa produkte dhe shërbime lidhen me turizmin, kurse për disa nuk ka një lidhje të tillë të dukshme. Nga intervistat dhe diskutimet në punëtori u identifikua një listë e produkteve dhe shërbimeve të mundshme: akomodimi, ushqimi/ushqimi tradicional, infrastruktura, guidat turistike, përkthyes, karburantet, zyrat e këmbimit të valutave, asistenca mjekësore, informacioni, transporti, shënjimi i rrugëve apo shtigjeve, logjistikë specifike (salla, sisteme të përkthimit simultan, akses në internet), hapësira parkimi, siguri, argëtim etj.

***Si përmbledhje, Krusheva dhe Elbasani tërheqin të njëjtat dy kategori turistësh: adhuruesit e natyrës që marrin pjesë në aktivitete aventuristike dhe familjet që udhëtojnë për pushime dhe përjetojnë eksperiencat lokale.***

Nga ana tjetër, të dy destinacionet lokale tërheqin një kategori të ndryshme vizitorësh për shkak të faktorëve autentikë të atraksioneve si vizitorët për mirëqenie dhe përmirësimin e shëndetit (Elbasani); vizitorë transit (Elbasani); paragjajderë profesionistë ose të apasionuar pas paragjajdingut (Krusheva); adhurues të historisë kombëtare (Ilindeni në Krushevë).

## **Strategjia e çmimeve**

Çmimi është vlera që turisti dhe ofruesi i produktit turistik e përcaktojnë për të mundësuar shkëmbimin. Për turistin, i cili në këtë rast është konsumator, çmimi që është i gatshëm të paguajë kur e viziton një destinacion është i barabartë me kënaqësinë e pritur që ai do të përjetojë. Nga ana tjetër, ofruesi i shërbimit turistik përpiqet të mbulojë kostot e tij dhe të marrë përfitimet e dëshiruara.

Strategjitë e njohura të çmimeve, si përcaktimi dinamik i çmimit, kërkimi i çmimeve, çmimi i bazuar në konkurrencën etj., janë shumë të ngjashme për t'u përdorur për një produkt që tashmë është në treg dhe për promovimin e tij aktual. Për produktet e reja, si "Krusheva dhe Elbasani - destinacion turistik i njohur ndërkuftar" dhe që është objekt i kësaj analize, literatura këshillon **zbatimin e strategjisë së çmimeve të penetrimit.**

Megjithatë, kjo strategji sugjeron çmime më të ulëta ose të barabarta me kostot e prodhimit, të cilat në rastin e Krushevë-Elbasanit nuk do të ishte e mundur të zbatoheshin, pasi produkti nuk zhvillohet apo



shitet vetëm nga një ofrues i shërbimeve turistike. Përkundrazi, produkti në rastin e destinacionit Krushevë - Elbasan, sipas kërkesave dhe nevojave, duhet të përfaqësojë një PAKETË AKTIVE TË PËRBASHKËT PËR TURIZIM, të përbërë nga disa shërbime të ndryshme turistike si akomodimi, guida turistike, transporti, eksperiencat lokale. ushqimi, aventura në natyrë etj.

Qëllimi i strategjisë për çmimet në këtë fazë të destinacionit Krushevë – Elbasan është tërheqja e vizitorëve dhe deri diku gjenerimi i vizitave që do të përsëriten.

Një faktor tjetër që ndikon në strategjinë e çmimeve është krijimi i perceptimit se destinacioni është “i plotë” dhe se është e vështirë të gjeësh një vend për ta vizituar atë. Kjo do të thotë, nëse ekziston dëshira për të vizituar destinacionin, për ta parë atë për shkak të atraktivitetit të tij, duhet të rezervohet paraprakisht. Nga ana tjetër, ekziston çështja e kapacitetit mbajtës turistik (TSS).

STO e përcakton kapacitetin mbajtës të turizmit (TSS) si numrin maksimal të turistëve që mund të vizitojnë destinacionin në një moment të caktuar, pa e shkatërruar mjedisin fizik, ekonomik apo social-kulturor dhe ulje të papranueshme të cilësisë së kënaqësisë së vizitorëve, që do të thotë se ai numër nuk është gjithmonë e barabartë me numrin e shtretërve/shtretërve që janë dispozicion në destinacion.

Megjithatë, analiza e dispozicionit të objekteve akomoduese tregoi se numri i shtretërve është shumë më i ulët se potenciali i destinacionit (42 shtretër mesatarisht janë të zënë çdo vit nga 1250 që janë në dispozicion në Krushevë), dhe me ardhjet aktuale, në çdo rast, kapaciteti mbajtës i turizmit (TSS) në destinacionin Krushevë dhe Elbasan nuk është arritur.

Për më tepër, strategjia për çmimet duhet të marrë parasysh vendndodhjen e produktit turistik dhe të ofrojë çmime brenda intervalit të kostove për inputet në produkt, siç janë kostot fikse (shërbimet komunale, pagat, taksat e pronës, etj.) që për atë destinacion/vend janë të rregullta.

Pozicionimi gjithashtu e përcakton çmimin, pasi diapazoni i çmimeve duhet të korrespondojë me nivelet e të ardhurave të synuara për segmentet e tregut si turistët potencialë në destinacion (profilizimi i vizitorëve të mundshëm u prezantua më lart, seksioni i segmentimit të tregut).

Promovimi i destinacionit si një “një udhëtim në dy vende” për aventura në natyrë dhe destinacion argëtimi familjar që ofron përvoja unike lokale (shih sugjerimet e USP-së më lart) ndikon gjithashtu në strategjinë e çmimeve. Destinacioni promovohet si një oazë natyrore ndërkufitare që ofron aventura të tilla si paraglajding, shëtitje ose rafting me akomodim autentik (stili i qytetit të Krushevës dhe stili i bujtinave fshatare të Elbasanit) dhe ushqime të shijshme. Strategjia e çmimeve duhet të ndërlidhet me përvojën e përgjithshme që ofrohet nga të dy destinacionet lokale.

Duke marrë parasysh aspektet e mësipërme të miksit të marketingut të destinacionit (produkti, vendi, promovimi), strategjia e çmimeve Krushevë – Elbasan duhet të bazohet në një përllogaritje kosto plus marzhi për dy destinacionet lokale veç e veç. **Është një koncept ngadhënjimtar si për ofruesit e turneve vendas ashtu edhe për turistët.**

Në këtë fazë të zhvillimit të PAKETËS SË PËRBASHKËT PËR TURIZMI AKTIV, strategjia e përbashkët për çmimet nuk është e besueshme. Gjegjesisht, produkti i përbashkët turistik ende nuk është pilotuar apo promovuar. Aktorët e interesuar nuk janë të lidhur në rrjet në nivel biznesi. Nuk ka asnjë organizatë gjithëpërfshirëse (DMO) që e koordinon dhe zbaton miksin unik të marketingut të dy destinacioneve lokale.

Hulumtime të mëtejshme duhet të pasojnë pasi destinacioni është vendosur në dy ekonomi të ndryshme, kurse çmimi i koordinuar i paketës së udhëtimit duhet të pasqyrojë tendencat e tregjeve kombëtare dhe të tregut të rajonit.

### Plani për marketing dhe reklamim

Para se të përgatitet plani i marketingut dhe reklamimit, elaborohen tendencat aktuale në industrinë e marketingut të destinacionit, që ato të shërbejnë si një kornizë e përgjithshme për aktivitetet specifike të planit të marketingut për Krushevën–Elbasanin. Vetë parakushti për zbatimin e një plani të vetëm marketingu, si dhe të çdo plani veprimi të marketingut, për cilindo destinacion, është të ketë një organizatë përgjegjëse për zbatimin e tij (qoftë ajo publike, private apo e themeluar nga disa aktorë të interesuar).

Në nivel projekti, sipas kërkesave që i ka detyra, plani indikativ i marketingut duhet të fokusohet më shumë në paketën e përbashkët turistike aktive për Krushevën dhe Elbasanin, e jo në promovimin e destinacionit të përgjithshëm.

Për këtë Analizë, ky plan indikativ i merr parasysh tendencat aktuale të marketingut:

MEDIAT SOCIALE janë kanali kryesor i komunikimit dhe marketingut, duke e ndjekur trendin aktual të industrisë në mbarë botën. Rrjetet sociale janë prioriteti kryesor për ndërgjegjësimin dhe njohjen e destinacionit Krushevë-Elbasan si destinacion aventuristik.

Për shembull, numri i tregimeve të ngarkuara (Story) në Instagram (IG), të cilat u lansuan për herë të parë në 2016, është rritur 11 herë nga postimet standarde (Feed) dhe përbëjnë 47% të të gjithë përmbajtjes në Instagram (IG). Historitë më të fuqishme në Instagram shpërndahen nga vizitorë të vërtetë që marrin pjesë drejtpërdrejt në aventurë/a në destinacionin e caktuar. Videot e vizitorëve me paragjajding ose rafting, të zhytur në natyrë spektakolare, janë “fjala re nga goja” në reklamimin.

Nga ana tjetër, jo të gjithë influencerët (njerëzit që paguhen për të reklamuar një destinacion) krijojnë promovim të barabartë. Mund të jetë e vështirë të përcaktohet se kush është influencer cilësor për të afruar destinacionin Krushevë-Elbasan deri te objektivi i identifikuar i turistëve të profilizuar.

Një qasje tjetër që është dëshmuar si efektive në mediat sociale është përfshirja e popullatës lokale në fushatat e marketingut për të përcjellë në mënyrë efektive kulturën dhe atmosferën e destinacionit.

Konkretisht, INSTAGRAMI është një platformë e fuqishme për tregim vizual. Instagrami e ka angazhimin më të madh për postim se çdo rrjet social – 84 herë më shumë se Twitter, 54 herë më shumë se Pinterest dhe dhjetë herë më shumë se Facebook.<sup>1</sup>

Duke pasur parasysh se 95% e përdoruesve të Instagramit janë edhe në Facebook (Pew Research Center), promovimi i gërshetuar i destinacionit do të nxisë arritjen dhe angazhimin e mëtejshëm. Për më tepër, pothuajse gjysma e të gjithë përdoruesve të Instagramit përdorin këtë aplikacion për t’i ndihmuar të tjerëve të zgjedhin një destinacion udhëtimi. Me reklamat dinamike në Instagram të udhëtimeve dhe rritjen e përdorimit të platformës së prenotimeve të udhëtimit, plani i marketingut mund të përcaktojë një buxhet të vogël për të targetuar udhëtarët e mundshëm drejt destinacionit Krushevë – Elbasan, duke ofruar paketa precize aktive të përbashkëta për vetë destinacionin.

Me më shumë se 2 miliardë përdorues aktivë në nivel mujor, FACEBOOK e mban pozicionin e tij si platforma numër një e mediave sociale për të arritur deri te vizitorët e mundshëm. E kombinuar me reklamat me pagesë dhe postimet e promovuara, mënyra më e mirë për të nxitur trafikun social për Facebook është të postohen përmbajtje të freskëta dhe unike. Mbi gjysma e përdoruesve të Facebook-ut thonë se fotot e miqve të tyre gjithashtu frymëzojnë planet e tyre për udhëtim. Meqenëse Facebook vazhdon të zgjerojë rolin e tij në hapësirën e udhëtimit me lansimin e funksioneve të aplikacioneve si “Guidat e Qyteteve” në vitin 2017, një konkurrent i drejtpërdrejtë i Google Travel, Facebook do t’i bashkohet më qartë radhëve të TripAdvisor, Google, etj. në planifikimin e detajuar të udhëtimit.

Njerëzit e përdorin Twitter-in për të zbuluar diçka të re dhe interesante, kurse udhëtarët e përdorin këtë platformë për të gjitha fazat: nga planifikimi i udhëtimit deri tek shkëmbimi i përvojave të udhëtimit. Ka 45% më shumë gjasa që përdoruesit e Twitter-it të postojnë opinione për destinacionet sesa përdoruesit e tjerë të mediave sociale.<sup>2</sup>

Videot e udhëtimeve janë ndër më të shikuarat në YouTube pasi kanali e ruan statusin e tij si motori i dytë më i madh i kërkimit në botë. Sot, platforma përdoret nga persona të moshës 18-49 vjeç, më shumë se çdo rrjet tjetër kabllor në SHBA.<sup>3</sup>

SEO, optimizimi i motorëve të kërkimit është më i rëndësishëm se kurrë. Më shumë se gjysma e udhëtarëve nën moshën 34 vjeç (që u përputh me profilin e turistëve që mund ta vizitojnë një destinacion aktiv për aventurë në natyrë), para se të marrin një vendim për të udhëtuar, përdorin një motor kërkimi të përgjithshëm për të kontrolluar akomodimet dhe aktivitetet dhe për të krahasuar çmimet me destinacionet tjera.

1 burimi Sprout Social

2 burim AdWeek


3 burim Hootsuite



Përveç përdorimit të mediave sociale dhe optimizimit të motorëve të kërkimit për qëllime marketingu, kjo Analizë i merr në konsideratë edhe mjetet tradicionale të promovimit. Një nga mjetet më të përdorura të marketingut në biznesin e udhëtimit B2B (B2B) është organizimi i FAM (turne për njoftim). FAM tours është një mjet marketingu për tërheqjen e ndërmjetësve (agjencitë e udhëtimit dhe operatorët turistikë) në destinacionin për shitjen e organizuar të paketave të udhëtimit. Zakonisht, të gjitha kostot për këtë mbulohen nga organizatori, DMO ose ndonjë organ tjetër përgjegjës. Agjencitë turistike i ofrojnë produktet/paketat e tyre të udhëtimit për grupe të organizuara, ose në rastin e Krushevë-Elbasanit, ato do të targetonin edhe personat e moshuar të interesuar për kulturën dhe historinë (shih segmentimin e tregut).

Shkurtimisht, plani i marketingut të destinacionit Krushevë-Elbasan duhet të detajohet dhe zbatohet nga një organ i unifikuar, DMO apo organ tjetër përgjegjës për marketingun dhe promovimin e destinacionit në tërësi. Ndërkohë, fokusi duhet të jetë në paketën e përbashkët të turizmit aktiv duke përdorur kanalet e mediave sociale dhe FAM turne.

Për sa i përket shpërndarjeve indikative sipas aktiviteteve reklamuese, prezantimi përkatës është dhënë më poshtë, duke ndjekur rekomandimin e literaturës për produkte turistike të reja ose në zhvillim:



Siç është paraqitur në grafikun 6, buxheti i reklamave në përqindje (%) përfshin investime në reklamat me pagesë në Instagram deri në 35%, Facebook 25%, FAM Tours 20% dhe shitje B2B deri në 5%.

Është e rëndësishme të adresohet mundësia e përbashkët dhe plotësuese e reklamimit në Facebook dhe Instagram, pasi të dy kanalet e mediave sociale menaxhohen përmes të njëjtave mjete. E njëjta përmbajtje e prodhuar mund të reklamohet lehtësisht në të dyja mediat sociale ose të zhvendoset në mënyrë përkatëse tek audienca e synuar të cilës i referohet destinacioni.

**Figura 6: pjesa e buxhetit për reklamim në %**

## VII. Paketa të përbashkëta turistike aventuristike në destinacionin Krushevë – Elbasan

Propozimi A: “Java e Aventurës së Natyrës” – e zhvilluar nga një grup i përzier aktorësh të lidhur me turizmin gjatë seminarit të parë të mbajtur në Elbasan më 18-19 maj 2022.

I destinuar për: grupe të vogla të organizuara, 8-12 persona;

Lloji i shërbimit: paketë e plotë e udhëtimit

Itinerari dhe programi i propozuar:



Hyrje:

Vendet malore të Ballkanit kanë ende perla të pazbuluara të natyrës dhe mikpritjes, duke iu ofruar turistëve mundësi unike për të eksploruar qytete dhe fshatra përtej kufijve. Një udhëtim ngazëllues në Maqedoninë e Veriut dhe Shqipëri do të zbulojë peizazhe të mrekullueshme, pasuri të madhe kulturore dhe histori interesante lokale. Gjatë këtij udhëtimi do të jeni aktivë dhe do të shijoni natyrën e bukur, duke e shijuar kuzhinën lokale dhe mikpritjen e jashtëzakonshme që mbizotëron në destinacionin e qyteteve Krushevë në Maqedoninë e Veriut dhe Elbasan në Shqipëri.



Është një udhëtim nëpër kohë, duke ofruar shtigje të shënuara në natyrën e paprekur për bjeshkatarë dhe çiklizëm, histori dhe kulturë që duhet të eksplorojnë, duke filluar nga vendet antike si Ad Quintum në Elbasan deri te Qendra moderne Përkujtimore e këngëtarit të famshëm maqedonas Toshe Proeski në Krushevë.

Entuziastët e natyrës i pret një kombinim i rrallë e kulturës dhe e udhëtimit aktiv, pasi mund të lëshohen në paraglajding nga qyteti më i lartë në Ballkan – destinacioni i njohur botëror për i paraglajding Krusheva, si dhe nga zona liqenit malor të Funarit pranë Elbasanit; mund të eksplorojnë pyjet, të hipni në kuaj, rafting në lumenjtë afër Elbasanit, skijim dimrit ose thjesht pushim në objektet për trajtim shëndetësor të Elbasanit, të

shijoni verë të mrekullueshme me kuzhinë tradicionale. Detoksimi urban është i garantuar në udhëtimin në dy vende - një përvojë!

### Programi ditor:

**Dita 1: Mbërritja në Elbasan (pika hyrëse Tiranë, Shqipëri). Dita 1:** Mbërritja në Elbasan (pika e hyrjes në Tiranë, Shqipëri), ushqim lokal për darkë dhe fjetje në Elbasan (mundësi qëndrimi në hotel në qytetin e Elbasanit, hotel SPA ose në bujtina - apartamente në zonat rurale përreth)

### Dita 2: Dita e Aventurës – eksploroni zonën e Funarit në këmbë!

Funari ndodhet në veri të Elbasanit, rreth 50 minuta me makinë nga qendra e qytetit, në një rajon malor. Në vitin 1967 atje janë ndërtuar katër rezervuarë uji, të cilët së bashku me pyllin me pisha përreth krijojnë një pamje piktoreske të liqeneve alpine. Zona është e freskët në verë dhe mjaft piktoreske gjatë dimrit me borë. Vetë zona është shumë e përshtatshme për realizim të aktiviteteve të ndryshme në natyrë dhe sporte.

Deri te zona e liqenit mund të arrihet në këmbë nga Funari, që ofron shëtitje midis peizazheve të mahnitshme natyrore!





### Dita 3: Shijoni natyrën – not dhe kajak në liqenet e Funarit

Shijimi i natyrës në zonën e Liqeneve të Funarit do t'ju japë mundësi të jeni aktivë dhe të zgjidhni mes notit në një nga katër liqenet me ujërat smerald dhe kajak për disa orë në freskinë e ajrit të pyllit. Njëkohësisht, zona e Funarit ofron udhëtime aktive, aktivitete në ujë që mbështeten me ushqime të shijshme të përgatitura nga popullata lokale, piknik në natyrë, buzë liqenit, duke e shijuar mjedisin dhe natyrën mahnitëse. Disa nga aktivitetet që mund të përjetoni janë:

- **Paraglajding:** kryesisht në pranverë dhe në vjeshtë, duke filluar nga pllaja e Cerujes (afër Funarit).
- **Gjuajtje me Hark:** në Elbasan ka një shoqatë që ofron eksperience në gjuajtjen me hark.
- **Kamping dhe gatim në skarë:** përreth liqeneve ka livadhe të paprekura, të cilat janë perfekte për kamping.
- **Kanu në liqene dhe sporte të tjera ujore.**
- **Çiklizëm malor në shtigjet nëpër pyllin rreth liqeneve të Funarit.**
- **Shëtitje rreth liqeneve të Funarit ose eksplorim i shtigjeve të tjera si Shpella e Mbytjes (Mollagjes, Mali i Korrës dhe Kanioni i Dopaj).**



### Dita 4: Njihuni me Jerusalem e Ballkanit - Ohrit, kulturë e qytetit dhe natyrën

Transferimi nga Shqipëria në Maqedoninë e Veriut, gjegjësisht në qytetin e Krushevës si qendra e dytë e këtij udhëtimit, nëse bëhet nëpërmjet Ohrit nëpërmjet kalimit të Qafë Thanës, është përvoja më e mirë.

Pas rreth 2 orësh vozitje (përfshirë kohën e kalimit të kufirit), vizitorët do të arrijnë në qytetin e Ohrit dhe liqenin më të vjetër në Evropë, atë të Ohrit. Ndani disa orë për të eksploruar vendlindjen e shkrim-leximit sillav, si dhe qytetin me 365 kisha. Plaoshniku, Kaneo, Kisha e Shën Sofisë, "Shtëpia e Skllevërve", Qyteti i Vjetër dhe Kalaja janë vende të popullarizuara për t'u vizituar nëse dëshironi të mësoni më shumë për historinë dhe kulturën e popullit maqedonas. Në një ditë të ngrohtë, mund të freskoheni duke notuar në ujin kristal të kaltër të liqenit të Ohrit ose të pushoni buzë bregut, duke e shijuar troftën e famshme të Ohrit. Udhëtimi vazhdon me transferim për në Krushevë nëpërmjet Manastirit. Fjetje në Krushevë, mundësi akomodimi në Hotel, SPA Hotel ose apartamente.





### **Dita 5: Përjetim me adrenalinë në qiellin e Krushevës**

Krusheva është një destinacion me famë botërore për paraglajding, i cili pothuajse gjatë gjithë vitit ofron aventura të paraglajdingut në tandem mbi luginën e Pelagonisë. Mënyrë e përsosur për të parë qytetin më të lartë në Ballkan nga lart është një fluturim me paraglajder mbi të; Aventurë e paraglajdingut në tandem me pilotë me përvojë dhe të licencuar do t'ju çojë nëpër dhe rreth këtij qyteti që ndodhet në 1350 m mbi nivelin e detit, duke ju mundësuar të shijoni për gjysmë ore pamjen e luginës së Pellagonisë, si dhe pyjet e dendura rreth Krushevës. Pas kësaj batice të adrenalinës, energjinë tuaj do ta riktheni me një drekë tradicionale të gatuar me produkte vendase në restorantet që ndodhen në qendër të qytetit. Këtu, në Krushevë, mund të shijoni ushqimin tradicional Çomlek, një tavë me miç viçi të pasuruar me specia, qepë, kumbulla të zeza të thata, verë dhe erëza.

Pasditja është e rezervuar për një xhiro në qytet me një guidë turistike, në mënyrë që të njiheni me historinë kryengritëse të popullit të Krushevit, Kryengritjen e llindenit dhe Monumentin Makedonium, simbol i luftës maqedonase kundër Perandorisë Osmane në fillimi i shekullit të 20-të. Përjetimi i shëtitjes në qytet mund të ëmbëlsohet me ëmbëlsirat tradicionale lokale – llokum ose celufki (puthje) nga të bardhat e vezëve dhe sheqeri, krokante, të bardha dhe shumë të shijshme.

#### **Dita 6: Eksploroni pyjet e vjetra të Krushevës duke kalëruar**

Natyra e paprekur ju pret për t'u detoksikuar nga jeta urbane ose për të shijuar ngadalë dhe plotësisht kohën. Kalërimi nëpër pyjet 300-vjeçare, ajri freskues dhe pamjet e bukura janë përvojë që rekomandohet në Krushevë. Për kalorës më me përvojë, ofrohen turne me kalërim, vetë ose me guidë, nëpër disa shtigje të cilat mund të zgjidhni dhe të shijoni rrethinat e liqenit të Krushevës ose dendësinë e pyjeve përreth. Megjithatë, gjysma e parë e ditës do të jetë e mbushur me relaks dhe peizazhe mahnitëse të natyrës së paprekur.

Ushqimi tradicional i përgatitur nga popullata vendase, i cili ofron peta dhe djathë, mund të shërbehet buzë liqenit dhe t'ju mundësojë momente të paharrueshme të kaluara në Krushevë. Pasditja është e lirë për të zbuluar dyqanet lokale, kafenetë dhe baret nëpër rrugët e ngushta të çarshisë së vjetër të Krushevës, në qendër të qytetit. Fjetje në Krushevë.

#### **Dita 7: Largimi nga Shkupi, Maqedonia e Veriut.**

**Propozimi B:** Një grup i përzier i aktorëve të interesuar që janë të lidhur me turizmin, \*gjatë seminarit të dytë të mbajtur në Krushevë në qershor 2022, e zhvilluan një ofertë turistike për një javë aventurë në natyrë.

I dedikuar për: grupe të vogla të organizuara, 8-12 persona;

Lloji i shërbimit: paketë e plotë e udhëtimit


#### **Itinerari dhe programi i propozuar:**

##### **Hyrje:**

Krusheva dhe Elbasani, si destinacion ndërkuftar, kanë një ofertë të kombinuar për turistët, ku përfshihen mjedise të paprekura, natyrë e mrekullueshme, trashëgimi historike dhe kulturore, perspektiva për turizëm aktiv/aventuristik (paraglajding, sporte aktive, bjeshkatari, çiklizëm malor, kanu, etj.). Dy zonat ndërkuftare janë të vendosura për të shkuar në nivelin më të lartë botëror si një destinacion unik dhe unik turistik.

Krusheva është një nga destinacionet kryesore në botë për paraglajding. Në vitin 2019, u organizua Kampionati i 16-të Botëror në Paraglajding. Mbi 5000 vizitat, në nivel vjetor, për aventura me paraglajding e vendosin Krushevën si destinacion në hartën botërore të udhëtarëve. Në të njëjtën kohë Krusheva po ndërmerr veprime për oferta turistike inovative (Promovimi i liqenit për not, kanu, shëtitje të lehtë rreth liqenit; Promovimi i shumë shtigjeve të reja të çiklizmit nëpër natyrën dhe pyllin e mahnitshëm; Parku aventurë dhe shkëmbi Bouldering; Skijim dimrit dhe sigurim të borës me topa bore kur është e nevojshme dhe përdorim të shtegut për skijim për vozitje me ATV gjatë verës; Kalërim nëpër pyllin/korinë e Krushevës; Shëtitje në malet dhe pyjet përreth Krushevës dhe mbledhje të luleshtrydheve të egra; Vizitë në spa qendrën në Hotel Panorama, etj.) të cilat tërheqin aventurierë dhe turistë familjarë të vijnë gjatë gjithë vitit

Elbasani është një dëshmi piktoreske e historisë. Elbasani përveç objekteve të banimit dhe dyqaneve tashmë përmban shumë objekte historike/kulturore si kisha, manastire, xhami dhe hamame (banjo publike). Një potencial specifik për zhvillimin e turizmit është Funari, një zonë e pasur me pyje me katër liqene apo rezervuarë të veçantë, dy në fshatin Funar dhe dy të tjerë të fshehur pas maleve që i rrethojnë. Me pak përpjekje, kjo zonë mund të kthehet në një zonë tërheqëse turistike ditore pasi klima e freskët, natyra mbresëlënëse dhe liqenet e krijuar nga njeriu nxjerrin në pah më të mirën e saj.





Të gjitha këto atraksione do të promovohen me këtë propozim paketë turistike.

Programi ditor:

**Dita 1:** Mbërritja në Krushevë, (pika e hyrjes Shkup, RMV), ushqim lokal për darkë dhe fjetje në Krushevë (mundësi akomodimi në hotel në Krushevë, hotel SPA, ose në ndonjë bujtinë tradicionale në qytet).





**Dita 2**– Shijimi i natyrës në Krushevë do t’ju japë mundësi të jeni aktivë dhe të zgjidhni not/kanu në liqenin e Krushevës, paraglajding tandem, ecjes nëpër pyll ose çiklizmit nëpër shtigje malore, vizitë në një park aventuristik dhe/ose vozitje të ATV nëpër terrenin për skijim. Pas kësaj batice të adrenalinës, energjinë do ta riktheheni me një drekë tradicionale me produkte vendase në ndonjë nga restorantet në qendër të qytetit. Këtu, në Krushevë, mund të shijoni ushqimin tradicional Çomlek, një tavë me mish viçi të pasuruar me specia, qepë, kumbulla të zeza të thata, verë dhe erëza.

